

INTERVISTË ME VEHAP SHITËN

Prishtinë | Data: 8 korrik 2013

Kohëzgjatja: 141 minuta

Të pranishëm:

1. Vehap Shita (I intervistuari)
2. Anita Prapashtica (Intervistuesja)
3. Donjetë Berisha (Kamera)
4. Anna Di Lellio

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Anita Prapashtica: Na tregoni diçka për fëmijërinë tuaj

Vehap Shita: Unë kom lind dikun në dimën të vitit 1923, në një familje zejtare. Babanë e kom pas rrobaqepës, por me të vërtetë prejardhja është intelektuale sepse gjyshi ka qenë hoxhë, ka qenë haxhi. Atëherë ajo pjesë ka qenë intelektuale për atë kohë, kështu që edhe babai im ka qenë i interesuar për shkollimin tonë. Na kemi qenë dy vëllezër, vëllau ma i madh Hyseni, ai ka qenë i caktuar nga babai im për t'u shkolluar, kurse mua ka deshtë të më nalë në dyqan të rrobaqepësisë. Kështu që unë do të bëhesha rrobaqepëse sikur të ndigjojshe babën, se babai im natyrisht ka pas nevojë për fuqi punëtore në atë kohë. E kjo ka qenë koha e krizës së madhe ekonomike në krejt Jugosllavinë e atëhershme por edhe në Kosovë. Kështu që baba im u detyrua të emigrohet në Shqipëri ku ka punu për dhjetë vjet, ka punu vetëm me djalin që e ka pas në shkollën gjimnazin e Shkodrës të asaj kohe. Në ndërkohë unë kom qenë nifar nxënësi i mirë në shkollën fillore dhe ni shok i imi i klasës, që ka qenë gjithashtu djalë hoxhe, ai ka pas me shku në medresenë e madhe të Shkupit, ka kërku që t'shkojmë bashkë. Unë kom qenë i dedikum me shku me u ba shegert¹ në dyqanin e babit, por dëshira për tu shkolluar më ka bërë që të shkoj edhe unë bashkë me atë shokun tim dhe unë fitoj në një konkurrencë bajagi [goxha] të madhe.

Po ju përmend se prej Gjakovës kanë qenë atëherë 12 konkurrent për provim pranues, kemi kalu ja gjashtë, prej atyre gjashtë-ve vetëm njëni ka marrë bursën e shtetit. E pa bursë ishte e pamundur me jetu se atëherë vetëm konvikti në atë shkollë paguhej 250 dinarë në muaj, kurse rroga ma e madhe e punëtorit në Gjakovë ishte 150 dinarë, ishte e pamundur me u shkollu. Edhe unë u gëzova që nuk mora bursë po kthehna në shpi te nëna mirëpo ai babai i atij shokut tim luftoi edhe ma nxeri bursën të Vakëfit të kësaj. Vaki është sikur bashkësia Islame tash në atë kohë, kështu që unë megjithatë meta në shkollë. Dhe mësimi bëhej në gjuhën serbe na kishin msu serbisht në shkollën fillore, por shkollën fillore e kisha krye përmendsh, tash në gjimnaz nuk mund të kalohej ashtu. Kështu që në semestrin e parë i mora tre dysha që ishin për mu... isha nxans i shkëlqyeshëm morra tre dysha. E tre dyshat më shkun në Gjakovë, në Gjakovë e kisha axhën, se baba ishte i emigrum në Shqipëri. E thërrasin atë i tregojnë se djali, nipi yt ose djali yt ka dysha. Atëherë unë bona çka bona, edhe fundin e vitit shkollor

¹ Ndhimës i mjeshtrit, punon për pak të holla.

megjithatë e kalova mirë me nota të mira, kështu që meta t'a vazhdoj shkollën medrese.

Tash po ju tregoj një... për mos me e zgjat këtë punë, po ju them se prej 120 nxënësve të klasës së parë, semimaturën që do të thotë shkollën, si me qenë kjo shkolla fillore e kemi kry gjithsej 24. Aq ka qenë kriteri shumë i rreptë por sidomos për shqiptarët, prej ktyne 24-ve ndër këta 24 isha edhe unë që kisha... Kështu që, në fund maturën prej asaj gjenerate mrrijta t'a kryej vetëm unë menoj prej gjakovarëve, se shqiptarë kishte edhe t'tjerë. Kishte shqiptarë që kishin kalu për shembull shok klase e kom pas Rexho Mulliqin për të cilin keni ndëgjju ju [i drejtohet të pranishmeve] sigurisht. Kom pas Hasan Kaleshin, nxansa shumë të mirë edhe të shkëlqyeshëm që krijuan karrierë në punën, në detyrën e vetë. Unë ndërkohë isha i lidhur me Shqipërinë, por baba për shkak timin nuk e mori edhe familjen me veti kështu që meti ai pa familje atje, unë pa babë këtu. Kështu që kalova pra ni fëmijëri jo fort të lumtur, se fëmija pa babë natyrisht që nuk e ka bash lehtë sidomos në atë kohë që ka qenë shumë kohë e vështirë, megjithatë unë u përbina disi.

Në 1941 kur u shkatërru Jugosllavia, atëherë u hap gjimnazi në Prishtinë. Ktu në gjimnazin e Prishtinës erdhën të gjithë nxënësit që kishin dëftesat e klasës së fundit. Na të Shkupit nuk e kishim atë dëftesë për arsye se Shkupi mbeti ndër Bullgari edhe bullgarët nuk e lejun marrjen e atyre dokumentave. Mirëpo kishim ato librezat, por librezat drejtorja na i pranoi në vitin e kalum, e jo në vitin në vijim. Për këtë arsye në gjimnazin e Prishtinës u bo një bojkot i mësimit për t'a detyru këtë drejtorinë që të na pranojë klasën edhe në bazë të librezave. Mirë ajo s'i kemi zakon na edhe shpejtë bojmë protesta, mirëpo protesta ishte shumë e mbrapshtë. Kërkohej të bojkotohej shkolla, bojkotohej mësimi të na pranoheshin këto dëftesa, libreza shkollore por me iniciativën e një grupi për fat të keq komunistësh, që ishin pak më të vjetër. Kërkohej që të mbyllej shkolla me pretekst se gjimnazi është fashist se atëherë fashizmi ishte. Mirëpo, drejtorja që ishte dhe ai stafi i profesorëve që ishte ndër arsimtarët më të mirë që kishte Shqipëria e të gjithë në atë kohë të shkolluar përjashta. Drejtor ishte Rexhep Krasniqi doktor i shkencave filologjike në Universitetin e Gracit të Austrisë, ishin krejt ishin njerëz të shkolluar. Edhe bohemi kundër që të mbyllej shkolla se ne mezi kishim pritur që të hapej shkolla në gjuhën shqipe, e tash të qohemi ne për me i mbyllë shkollat.

Kështu që në atë kohë, po hyna në këtë muhabet për t'iu tregu se në atë kohë unë meta në anën e kundërt të asaj pjese që kishte organizu protestën. Bile tre vetë, tretë që ishin si udhëheqës të asaj proteste, ishin të gjithë të klasës së tetë, njerëz të formum. Ndër ata edhe Alush Gashi për shembull që dikur u bo këtu njëfarë faktori pas lufte, u përjashtua nga shkolla, por shkolla shpëtoi. E shkolla shpëtoi, por të gjithë të tjerët, krejt nxënësit pa marrë parasysh çfarë orientimesh politike, ose ideologjike tash po i thonë, kishin mbetë në shkollë dhe shkolla vazhdoi deri në vitin '44. Edhe të gjithë ata që kishin nisë mësimit në kohën e Jugosllavisë e që nuk kishin mbërri me e kry shkollën, e kryen shkollën praktikisht. Kështu që prej gjimnazit të Prishtinës, gjimnazit Sami Frashëri edhe sot e mbanë atë emër edhe atëherë e ka pas ka qenë gjimnazi Sami Frashëri, por me orientim që të bëhej Shkollë Normale se atëherë Kosova kishte nevojë shumë për mësues. Kështu që shkolla e Prishtinës u

bo Normale, por vetëm na që e kishim nisë gjimnazin deri sa e krym.

Pra, Shkolla Normale masi hyra tek kjo, t'iu them edhe një fjalë, se ai pushteti i atëhershëm edhe pse ishim nën okupacionin e fashistëve dhe Italisë fashiste por kishte një politikë shumë të mirë për sa i përket zhvillimit të Kosovës. Kosova kishte nevojë për kuadro, s'kishte kuadro. Viti '41 Kosovën e ka gjetë me gjithsej 60 studente që kishin kryer fakultetet në krejt Jugosllavinë. Krejt Kosova kishte 60, prej atyre shumica juristë, ndonjë ekonomist por krejt jurista kryesisht; ose ksi që kishin kry kto fakultetin teologjik, se prej medreses mund të shkojsh edhe në teologji.

Kështu që, Ministria e Arsimit e asaj kohe në krye me Ernest Koliqin bëri një politikë shumë të mirë për sa i përket organizimit të mësimin, shkollave. Në Prizren u hap gjimnazi, në Mitrovicë shkolla teknike, në Pejë shkolla bujqësore, Prishtinë shkolla normale, pra u mbuluan të gjitha degët kryesore që duhet. Ata nuk llogaritshin që ajo koha e tyne do të zgjaste tre-katër vjet, ajo nuk do të mund t'baheshin, por perspektiva ishte aty se ato shkolla, ato profile të shkollave u vazhduan mandej edhe në '45-shin, kur Kosova u bo autonome qysh u bo. Tash në këtë situatë, në kohën sa isha nxanës, unë në vitin '41 nuk isha me Lëvizjen Nacional Shqiptare por në '42-shën u bona njoni prej aktivistëve të shquar të Lëvizjes. Kështu që, më ra me takoi të marrë pjesë vetë tash në demonstratë kundër regjimit fashist të atëhershëm e kundër okupatorit. Shiqoni ajo edhe pse ka qenë Lëvizje Nacional Shqiptare e udhëhequr prej komunistëve, e komunistë kishte pak shqiptarë, kështu që... Mirëpo me kohë u zhvillu ajo lëvizje, edhe në demonstratën në Prishtinë që u majt diku në shkurt të '43-shit, unë morra pjesë në demonstratë edhe fola, mas kësaj demonstratë rashë edhe në burg.

E tash ku e pata ktu... unë ju fola për... kur mora pjesë në demonstratë e rash në burg. Mirëpo, edhe pse ishte koha e luftës shteti shqiptar i asaj kohe ishte shtet shqiptar edhe punonte në baze të ligjeve kushtetutës që ishte. Edhe pse e okupuar ishte në fuqi. Kështu që, ajo, stafi i punës t'u fillu nga ministritë e deri tek komuna, të gjitha ishin të interesuara për shkollimin e rinisë. Mirëpo unë në këtë kohë, përpara se me, qysh në fmini, qysh si nxans i gjimnazit pra si me thonë i shkollës fillore, se gjimnazit i thojshin atëherë gjimnazi ishte tetë klasësh, unë jom interesu shumë për letërsi edhe për teatër sidomos. Kështu që unë u orientova nga shkrimet edhe pse në fillim. Pra vitin kur e kreuva maturën, e kreuva maturën dikur ka fillimi i '45-ës se rash në burg përsëri.

Rash në burg edhe në kohën e gjermanëve, kisha ardhë e kisha kry klasën e tetë edhe erdha me dhanë maturën. E rashë në burg në Prishtinë, se gestapoja më kërkonte në Gjakovë e unë isha ilegal në Prishtinë, po ilegal isha për pushtetin, për policinë, jo për gjimnazin (qeshë). Mirëpo u burgosa. Nejsë kur e kreuva e tash edhe u shliku menjshim që u shliku Kosova, nuk e dishim që po hyjmë në një okupacion të ri. Se atëherë me të vërtetë shqiptarët ishin ata që e bojshin ushtrinë nacional shlirimtare të asaj kohe, partizanet ishin, tu fillu prej komandantit e te poshtë krejt shqiptarë ishin. Edhe unë isha bo me ata. Mu nuk më takoi shumë me qenë partizan për arsye se unë isha nifur punëtori, në politikë veprimtar që po i thonë tash. Kisha nevojë për propaganda për me shkru e për

me kështu. Se gjithmonë më ka shku shkrimi, jam marrë me shkrime si me thanë.

Edhe tash, për me përparu Kosovën çka duhej? Duhej kuadrat që do ta ngjallshin ekonominë. Është interesant na kur kemi ardhë në '44-shin, '45-shin puna e parë ka qenë me ngjallë ekonominë. Për shembull, unë t'u qenë sekretar i këshillit të rrethit në Gjakovë, sekretar edhe i këshillit të komunës sikur këta... sekretari kishte sikur tash kryetari si Isa Mustafa që është kryetar i partisë por është edhe kryetar i pushtetit, e unë kom qenë ekzekutiv. Edhe, prej ni grupi prej katër-pesë deri 12 rrobaqepësish e formova kooperativën e rrobaqepëseve. Qajo kooperativë e cila me kohë erdh e u bo kombinat, i cili mbërijti me e shitë mallin e vetë prej Gjakovës, jo vetëm në Kosovë por edhe në krejt Jugosllavinë madje edhe përjashta. Të i'u japi ni detal, kjo kooperativa që u bo mandej u bo kombinat. U bo ndërmarrja "KNAPERDAKSUEJ" që do të thotë "Përparimi", arriti të kontraktojë me Gjermaninë për t'i qepur uniformat e VERMATIT Gjerman që është shumë sukses i madh se ata janë tregtarë. Kta kanë mrrri me përparu këtë teknologjinë e punës, me liru çmimin edhe na shqiptarët ka dashtë Zoti kemi fëmijë boll, edhe kemi rini sa të dush edhe fuqia punëtore ma e lirë në Evropë është në Kosovë. Ndoshta, mund të na konkurroj ndonjë shtet i Amerikës Latine ose i Afrikës se përndryshe kërkush nuk ka ma shumë rini dhe ma shumë të pa punë. Kështu që arritën kjo...

E tash po e përmend këtë për arsye se unë në '45-shin në vend që të regjistrohesha në Fakultetin e Letërsisë ose të Arteve diçka, u regjistrova në Fakultetin e Xehetarisë, me u bo inxhinier i xehetarisë, se e disha që e kemi Trepçën, e kemi Obiliqin, i kemi këto resurset natyrore të Kosovës. Për sa i përket ekonomisë, jonë në minerale edhe në bujqësi se e kemi klimën shumë të bukur, kemi ujë mjaft, kemi diell mjaft, e kemi klimën shumë të butë shumë të mirë. Kosova ka resurse për një zhvillim jashtëzakonisht të madh.

Po kalojmë prej temës në temë. Unë kur kom qenë gazetar m'ka ra rasti me u taku me një grup gazetarësh të Japonisë që kanë ardhë me pa gjendjen në Kosovë, se ka qenë Kosova atraksion për botën e përparshme, një vend i pa njoftun. Edhe ka bo vizitën, edhe ka studiu rrethanat, resurset që i ka Kosova edhe në një raport që shkruhet se Kosova ka mundësi me pas pesë milion deri në gjashtë milion njerëz me u rritë, me jetu edhe me punu. E na atëherë s'kishim pesë- gjashtë qind mijë i kishte krejt Kosova. Ajo veç një zero i'a shtoi i boni pesë- gjashtë milion. Pra, Kosova që sot për shembull ka aq shumë nevojë për me i'u gjetë punë njerëzve, kemi aq shumë të pa punë, kemi aq shumë të rinjë. Sot po shohim në gazetë se qysh po shkojnë përjashta po ikin, ka disa autobusa po shkojnë për Beograd e prej Beogradit me shku përjashta. Sot po dalim na "E pse s'kemi vende pune këtu?", e s'kemi vend pune për arsye se nuk e kemi zhvillu. Edhe unë me atë rininë time kom shku jom regjistru në atë fakultetin. Nuk kaloi shumë pak kohë edhe më tërhoqën prej atij fakultetit e me qun' në nifar kursi, e më tërhoqën nga shkolla...

Anita Prapashtica: Çfarë kursi?

Vehap Shita: Ai ka qenë kurs për kooperativa, po për udhëheqës kooperative. E t'u bona unë nifar udhëheqësi i kooperativave në vitin '46. Merreni me mend prej një veprimtari që isha politik, atëherë isha 20 vjeçar nuk isha (qeshë) edhe mandej prej aty më futën në burg prapë. A e dini pse me kanë fut në burg? [I drejtohet të pranishmeve] Është interesant me i'u tregu edhe këtë detal. T'u qenë sekretar i këshillit të rrethit të Gjakovës, unë edhe pse nuk kisha ndonjë emër as si luftëtar, edhe isha i ri, isha atëherë isha 20 vjeç, as 20 nuk i kisha 19 ashtu, e krye komandanti i partizanëve atëhere Fadil Hoxha ishte komandant, me propozon edhe më bon sekretar ekzekutiv të këshillit të rrethit të Gjakovës. Edhe, t'u qenë unë në atë funksion, marrim një urdhër nga Beogradi, nga Beogradi jo nga Prishtina, që mos të lejojmë kthimin e kolonistëve në fshat por t'i nalim në qytet. Për arsye se ktheheshin në fshat edhe thoshin po kthehen në tokën e vet, e kjo është ajo toka që iu kishte dhanë me Reformën Agrare kur i'u kishin marrë shqiptarëve tokën e vetë e i'u kishin dhanë malazezeve. Por shifni aty ka qenë një dredhi shumë e madhe e bërë edhe atëherë, po e vazhduar edhe më vonë, pse? Pjesa e madhe e pasanikëve të qytetit të kohës së Turqisë e krejt të atyre kohëve që kanë qenë pasanikë në qytet me paret e qytetit ose si dhurata që i kanë marrë prej pushtetit turk, kanë marrë toka në katun. Por tokën katundaret që e kanë punu, e kanë punu me qesim, me qera e kanë marrë, si qifqi kanë punu. Tash... mirëpo ajo tokë ka qenë e regjistruar në emër të ktyne pasanikëve, e kur u bo Reforma Agrare në '32-shin, '33-shin, '34-shin në kohën kur ka qenë vështirësia ma e madhe edhe në Kosovë sikurse krejt, edhe në botë ka qenë në ato vite. Ju keni msu [i drejtohet të pranishmeve] sigurisht për recesionet e këto që kanë qenë, e atëherë tokën e kanë marrë prej katundarëve që e kanë punu edhe katundarët kanë qenë qifqi, katundarët nuk kanë qenë pronarë por ata kanë marrë si tokë të Begderve, si tokë të Spahive si tokë të Agallarëve që në të vërtetë qashtu ka qenë, por punëtorët në të vërtetë kanë qenë t'tanë kanë qenë fshatarë të thjeshtë.

Tash në këtë situatë, kur po kthehen në '45-tën, këta komunistët prej Malit të Zi, se kanë pas ikë në kohën e luftës, po shkojnë në katund. Po katundi po thotë po kthehet e vjetra edhe u krijuan divergjenca të mëdha të cilat u shndërruan edhe në kryengritje, keni ndëgju për kryengritjen e Drenicës, për kryengritjen e Gjilanit, Ferizajit por e Drenicës ka qenë ma e madhe. Tash në atë kohë unë si sekretar i këshillit të rrethit, nuk kom leju që të kthehen këta malazeztë, kolonistët malazez në katund, por i kom nalë në qytet. Kjo ka qenë koha fillimi i '45-shit, koha kur nifar Miladin Popoviç² ka qenë hala gjallë. Milladjen Popoviç u vra në mars të '45-shit e në vend të tij erdhi Gjoka Bajkoviç, e Gjoka Bajkoviç kurrë nuk ka qenë në Kosovë, as para luftës as mas luftës.

Gjoka Pajkoviç i cili erdhi në prill të '45-shit në Kosovë edhe pse ishte kuadër i Malit të Zi. Tash këta kolonistët malazez që ne në Gjakovë i ndalëm e nuk i lejuam me shku në katund u ankuan tek ky se ky ishte sekretar, ishte gjithëçka për Kosovë. Na i thojshim gaullajter i Kosovës. Gaullajter kanë qenë

² Miladin Popoviç ishte revolucionar, i takonte lëvizjes anti-fashiste në Kosovë. Me iniciativën e tij u formua Komiteti Nacional- Çlirimtar i Shqipërisë, Shtabi i Ushtrisë Nacional Çlirimtare të Shqipërisë, dhe më vonë Këshillin Ani-Fashist dhe Komitetin Kombëtar të Shqipërisë. Punoi në drejtim të krijimit të një partie të bazuar në Frontin Popullor, organizoi greva të minatorëve dhe punëtorëve të hekurudhës.

udhëheqësit nazist gjermanë që emëroheshin në një shtet të okupuar dhe bojshin çka t'dojshin se ata ishin gjithëçka. Edhe ky ishte që bonte gjithëçka edhe pse nuk ishte kryetar i kuvendit, fjalën e kishte ky si kryetar i partisë, ankoheshin tek kta. Edhe tash ky kur po vjen në një vizitë në Gjakovë, po vjen bash në këshillin e rrethit ku unë isha sekretar edhe ekzekutiv si t'i themi, ka thonë "Ku është ky sekretari që po na i përzënë njerëzit tanë?", demek unë po i përzë malazetë prej qytetit s'pi lo me shku në katund. Unë i them, "M'falni unë nuk e kom përzënë kërkend por jom t'u e zbatu urdhrin. Jom t'u zbatu direktivën që na ka ardhë nga Beogradi nëpërmjet Këshillit Krahinor" që ishte atëherë sikur tash, që është tash ky kuvendi edhe e kisha për fat me shkrim atë urdhrin. Mirë ai nuk mujti me marrë kurgjo masa kundër, deri doli ajo si një lloj humorit e jo naj gja e madhe.

Mirëpo mas një muaji mu më hoqën nga detyra edhe u transferova në përkthyes në komitetin qendror të Shqipërisë. Tash kur isha në Shqipëri në këtë kohë krejt marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave kalojshin nëpër duar të mija. Pse? Ato që ishin serbisht duhej t'i përktheja shqip, ato që ishin shqip duhej t'i përktheja serbisht. Unë nuk kisha ndonjë funksion atje, por si përkthyes kisha rol shumë të madh, isha njeri i besueshëm se nuk do të ma lejshin në dorë ni punë të këtillë. Edhe aty kom punu për shembull, në zyre kom pas shef gruan e Mehmet Shehut, ke ndëgju noshta [u drejtohet të pranishmeve]. Ajo ka qenë, edhe ajo ka qenë personalitet, pjesëmarrëse e lëvizjes funksionare, njëra prej femrave të shkolluara të asaj kohe që ishte... edhe Shqipëria kishte pak femra të shkolluara. Ajo gruaja e Mehmetit e gruaja e Enverit ishin shoqe, kështu që më ra unë me u taku, me qenë në rrethin e bllokmenëve që po i thonë të Shqipërisë. Pra Nako Spiron e kisha kojshi të zyrës, gruan e Mehmetit e kisha në zyre bile shefe të shërbimit, kështu që isha bo nifar funksionari aty, jo funksionar me detyrë por me punë praktikisht.

E tash në ndërkohë u hapën fakultetet në Beograd, kërkova unë që të lirohem nga ajo detyrë e të vi në fakultet. U lirova vetëm me intervenimin e Enver Hoxhës, se Enver Hoxha vinte nëpër zyrën time shkonte te Nako Spiro. Keni ndëgju për Nako Spiron, Nako Spiron gjithashtu ka qenë personalitet në atë kohën kur kam qenë unë. Ai ka qenë shef i Agil Propit, do të thotë shef i propagandës edhe ka qenë anëtar i byrosë, komitetit qendrorë e krejt këto. Bile ai edhe bëri vetëvrasje masanej në '47-shin, masi jam kthi nga Beogradi nejtse, por ishte me rëndësi që mua nuk më lejojshin. Enver Hoxha më liroi për me u kthi, për me shku në shkollë. Enver Hoxha në atë kohë, unë po flas për atë periudhë nuk po flas për periudhën ma vonë, atëherë ende nuk ka pas këso krime që janë bo ma vonë, ka qenë henez [ende] fillimi, kanë bo krime por me masë. Mirëpo Enveri mu më ka pëlqye një gja tek ai, ai jo që më lejoi mu me ardhë në fakultet po krejt njerëzit e vet që kanë qenë nëpër funksione të ndryshme, qoftë në ushtri, qoftë në administratë, qoftë në polici e që kishin mundësi për me e vazhdu shkollimin ton i qonte në shkollim. Që është një orientim shumë i drejtë, se krijimi i kuadrove udhëheqëse të punëve, të veprimtarive, jo udhëheqëse pse bohet naj shef kështu por pse udhëheqë ekonominë, udhëheqë shkollën, arsimin.

Edhe unë u ktheva në fakultet, krejt kjo që po ju them unë po du me ju thonë diçka tjetër. Tash kur unë

isha në fakultet e më tërhoqën nga fakulteti edhe kryetari i kuvendit të Kosovës që ishte malazez po më thotë mu, “Ti ke shku atje me shti qantën, ktu me ardhë me na shitë mend neve.” Se ton këta ishin pa shkollë, kishte që se kishin kry as semi-maturën. Për shembull ka pas njeri që ka qenë në funksion, e semi-matura ishte niveli i shkollës fillore sot është i shkollës fillore, por atëherë ka qenë diçka tjetër nuk ka qenë sikur që është sot. Edhe unë u ktheva, unë tash e u bona me u marrë me kooperativa, që s’kisha lidhje me kooperativat fare. Nejse por ndodhën mandej prishjet e më futën mu në burg, e tu qenë në burg... A e din pse rashë në burg tash? Unë e kom pas një dhondër i shtëpisë sonë, dhondër i familjes sonë ka qenë komandat i policisë në Prizren në kohën e okupacionit. Ç’është e vërteta ai nime ka qenë qashtu qysh e kemi mendu krejt tjerët, por ka qenë njeri shumë i zoti, dhëndër i joni e ai kur kom ra unë në burg...

E tash kur jon varë në Gjakovë më 44-shin, në gusht të 44-shit, jon varë dhjetë në Gjakovë, dhjetë në Prizren, unë kam qenë në burgun e Prishtinës tash i burgosur nga Gestapoja. E lypke Gestapoja kush është ai që është dërguar nga Gjakova për organizimin e rinisë në Prishtinë. Unë isha ai, por isha me emrin ilegal. Emri ilegal ishte Fatos që e ka djali jem, sot e ka emrin Fatosi. E ata e lypshin Fatosin nuk e lypshin Vehap Shitën se nuk e dishin. Unë si Vehap Shita kisha ardhë me dhonë maturën, edhe isha t’u fjetë ilegalisht në dhomë me Shaban Hashimin. Ndoshta ju kujtohet ka qenë inxhinier edhe doktor i shkencave, profesor i Universitetit Teknik ktu, me Selami Hallaqin ton këta janë burgosë.

Selamiu ky ka vdekë, Selamiun e kanë varë bile ka qenë njëri prej të varurve tash qatëherë kur jon varë këta unë kom qenë në Prishtinë. Mirëpo osht’ thonë shumë kohë më vonë, unë tu qenë në Prishtinë si i burgosun, unë kom qenë në dorë të Gestapos, me ka munu Gestapoja me kanë mbytë së rrahuri, për me pranunë që unë jam Fatosi, e unë s’kom pranunë që jam Fatosi se dokumentacionin e kom pas tamon. Mirë tash akuzohesha se ai dhondri jem, dhondër i shpisë me ka nxjerr mu prej duarve të gjermanëve edhe në vend të meje e kanë varë vëllau e Fadil Hoxhës. Vëllau I Fadil Hoxhës përnime osht’ varë, por osht’ varë si vëllau i Fadil Hoxhës jo pse ka punu diçka. Unë përnime kom shpëtu edhe më ka nxjerrë ky prej gjermanëve e më ka shti në burg të shqiptarëve, kur me ka shti në burg të shqiptarëve un kom shpëtu gjallë, e ka mbaru ajo faza qashtu, mu me kanë kthy prapë në burg te kta, por kur jon varë ata unë s’kom qenë aty.

Tash unë 11 muaj kom nejtë në burg, 11 muaj e gjysmë në burg të Oslos për me vërtetu që unë kom qenë në Prishtinë kur jon varë ata. Edhe ai u burgos në Tiranë, nuk u burgos as në Gjakovë as në Prishtinë, ka qenë tregtar e kanë marr se ka qenë vëllau I Fadil Hoxhës jo pse... U vërtetu kjo, atëherë më shtinën në burg e më dënun pesë vjet. Tu qenë unë në burg ky Gjoka Pakoviqi vjen në këtë shpi, e unë këtë shpi e kom ble në ‘46-tën, në të vërtetë jo unë por nana ime dhe vëllau ma i madh kur kom qenë unë në Shqipni, e kanë shitë shtëpinë në Gjakovë e kanë ble në Prishtinë. E tash kta m’kanë qit mu, ai bash ai ka ardh pse kjo shpija ka qenë atëherë shume e bukur, ndër ma të bukurat për atë kohë. Edhe unë i hongra pesë vjet burg por nuk i majta, se kjo gruaja jem e ka pas ni babë plak, veç vetë ka qenë mjaft e zgjutë kjo [i referohet bashkëshortes] edhe pse nuk ka shkollë të madhe kto unë prej

gjimnazit e kom pas, e kom marr në qafë (qeshë) ka shku në Beograd dhe menjëherë ma kanë zbritë dënimin dhe jom liru.

Tash po I kthehem unë punës, qasaj punës kur kom qenë nxënës. Unë kur kom qenë nxënës kom shku prej klasës së parë kom shku në teatër rregullisht, bile jonë habitë ata qysh u bona unë kritik i teatrit. U bona kritik i teatrit e as nuk kisha qenë në akademinë e teatrit, kisha studiu, por kisha studiu gjuhë dhe letërsi jo teatër (qeshë) edhe fillova të merrem. Tash kur u ktheva prej burgut hina u bona mas pari korrektor, mandej gazetar, mandej redaktor e deri ku u mërrina, por krejt ton kohën jashtë partisë se unë u përjashtova prej partisë në '47-shin. Tash veç kom pas ni fat shumë të madh se '48-shi kur u prish Shqipëria me Jugosllavinë, e Jugosllavia me bashkimin Sovjetik unë isha në burg edhe meta pa u burgos në Goljotok e unë shpëtova prej Goljotokut. Kur u ktheva prej burgut hyna në shtypshkronjën n'fund që u bo Rilindja edhe prej aty kalova në shtëpinë botuese. Prej shtëpisë botuese u bona gazetar i Radio Prishtinës por gjithnjë i përjashtuam, gjithnjë i njekun. Ç'është e vërteta dojshin me më nxënë pak, por nuk e hajsha se e kisha kalu këtë fazën e kësaj. Kështu më afroreshin kta të Adem Demaqit e ku di unë, unë thosha unë e kom la temën boll kom, qe dy vjet (qeshë).

E tash në fushën e gazetarisë e ne fushën e letërsisë unë natyrisht bona nifar karriere, fillova botova dy libra për teatrin, dy libra për letërsi por merresha me përkthime ma shumë. Pse me përkthime ma shumë? Mas pari niher isha i përjashtuam nuk kisha mundësi me bo karrierë ktu, unë kom pas karrierë politike deri sa kom ra në burg por masnej jo. Mirëpo në '66-shin kur u bo ai Plenumi i Brionëve³, a keni ndëgju për Plenumin e Brionëve? [I drejtohet të pranishmeve] Ai Plenumin i Brionëve kur u dënuan këto deformimet që ka bo sigurimi shtetëror në Kosovë kundër shqiptarëve. Kur u bo Plenumi i Brionëve u bo nifar kthese, u bo nifar liberalizimi në krejt Jugosllavinë e ai liberalizim sido kudo do të reflektohej edhe në Kosovë, edhe u reflektu në Kosovë. Mu më kthyen në parti në '66-shin, kur u ktheva unë në parti isha nifar intelektual i për atë kohë, e u bona anëtar i komisionit për çashtje ideologjike. Fillova me i'u bo referate ktyne punëtorëve që kishin funksione, me i'u bo referate unë mi shkru kta m'i lexu natyrisht (qeshë). Mirëpo çka piqet nuk hiqet, unë shumë shpejt fillova me ni veten të lirë, fillova me shkru vetë.

E tash isha gazetar i Rilindjes më kishin marrë prej Radio Prishtinës si kuadër, kur filloi Rilindja me dalë e përditshme duhet të forcohej me kuadro, njeni prej tyre unë edhe i dëgjueshëm edhe pse nuk isha në parti kur më thanë me kalu kalova, urdhër i partisë s'ki qare. Edhe u bona redaktor i Rilindjes, u bona kryetar i Shoqatës së Gazetarëve, u bona nën kryetar i klubit të punëtorëve letrar, u bona nënkryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve, u bona anëtar i kryesisë së Lidhjes së Gazetarëve të Jugosllavisë, shkova në ton këto qe po i'u përmendi juve pa qenë anëtar partie.

³ Plenumi i Brionëve u formua me 1 korrik 1966. E iniciuar nga Tito, ky Plenum përveç vendimeve të tjera, morri vendimin për largimin nga skena politike Aleksandër Rankoviqin dhe "realizimin e menjëhershëm të barazisë nacionale, posaçërisht asaj shqiptare".

Anita Prapashtica: Na trego pak ma gjerësisht për Lidhjen e Shkrimtarëve, Lidhjen e Gazetarëve të Kosovës, të Jugosllavisë, qysh keni hy?

Vehap Shita: E tash po i'u tregoj. Pra, gjatë tanë kësaj kohe unë nuk isha anëtar i partisë, jo tashi veç isha prej '66-shit por tash po vim tek '72-shi në kohën kur unë për herën e dytë po përjashtohem prej partisë edhe kur po shkarkohem prej krejt funksioneve. Në '72-shin, në kohën kur Kosova ishte në lulëzim të zhvillimit të vetë, kur nuk ka pas lulëzim ma të madh Kosova se në vitet '70. Pra mas demonstratave të '68-shit, që u bonë demonstratat e para të studentëve, Kosova nuk ka nejtë rahat as prej '44- '45-shit por këto që janë pak ma të njoftuna që kanë metë. E prej asaj kohe fillun shqiptarët me marrë frymë pak ma lirshëm edhe unë t'u e ditë veten që jom ma i lirë shkrujsha gjana që nuk i pëlqejke ni kategorie, por i pëlqejke kategorisë tjetër, se Jugosllavia ka pas gjithmonë opozitë. Opozita ka qenë herë ma e heshtur herë nuk ka qenë e heshtur, e sidomos nuk ka qenë e heshtur në Slloveni, nuk ka qenë e heshtur në Kroaci, në disa qarqe të Serbisë, në Vojvodinë.

Në disa qarqe besa edhe mrena në Beograd, në ato qarqe nuk ka pas serb që ka pranë që Kosova të ndahet nga Serbia, pa marrë parasysh a ka qenë komunist a ka qenë demokrat a radikal a çka kanë qenë, ton kanë pas qef. Por ka pas njerëz që kanë kerku që shqiptarët të jenë të barabartë më të tjerët, të kenë të drejtën e shkollës, të punës, të zhvillimit, të fjalës, ka pas të tillë. Edhe unë fillova me shkru për shembull njëfarë regjisor i filmit nga Beogradi, profesor I akademisë së arteve, profesor i regjisë se filmit mori regji me titull "Takimi i Shekujve".

"Takimi I shekujve" ishte një film dokumentar po i metrazhit të gjatë, që ishte përgatitë për t'u shfaqë nëpër përfaqësitë Jugosllave nëpër botë, për të tregu takimin e shekujve në Kosovë. Mbrapa mbeturinë e trashëgume, me përparimin e sjellun nga regjimi i tashëm nga zhvillimi tashëm. Edhe ai film po shfaqet në Kosovë në klubin e shkrimtarëve ku është tash kino ABC 1 a 2, që e ka pas një sallë të madhe, ajo salla nalt që osh't', por në projeksion të mbyllur, vetëm për intelektualët. Unë merresha me kritikë të teatrit por merresha edhe me kritikë të filmit, pa qenë asnjëherë në Akademi, as nuk e di ku është Akademia në Beograd. Unë shkruaj kritikë edhe e botoj kritikën "Kush po kërkon xhungllën në Kosovë?" titullin. Ai thotë "Takimi i Shekujve" unë thom "Kush po e kërkon?", ai po vjen nga Beogradi e po e kërkon xhungllën. Po kërkon njerëzit veç që s'po e hanë njani tjetrin edhe atë e botoj te na në gazetën "Përparimi" shqip. Mirëpo atë kërku nuk po e vëren se shqip, s'po ia vënë veshin fort, se edhe pak lexojnë shqiptarët edhe politikanët veç me qenë naj gja politike fort ose qe i'u intereson ata vetë për veti, nuk boni ndonjë jehonë.

Mirëpo unë atë e përkthej dhe e botoj në "Vijesti Srijedu" në Zagreb, ishte një gazetë që botohej në 250 mijë kopje edhe shpërndahej nëpër krejt Jugosllavinë. Se ishte gazetë shumë atraktive, që atraksionin e don njeriu, se mas pari e lexon ato që jon kush kon e ka vra, ndamje kon o bo, por edhe politikisht ka

qenë shumë e naltë, ka qenë opozitë praktikisht. Kjo osht' gazeta që në vitin 1971 u bo ajo lëvizja e masave, *masovni pokret* që ka qenë sekretar i organizatës së rinisë jugosllave edhe udhëheqës i lartë bile edhe politikan ideolog, u hoqën krejt ato... Pra ishin qajo kategori e njerëzve, e boton në gjuhën serbe edhe kroate, mirëpo unë dola në sipërfaqe si një lloj opozite, tu qenë në parti, tu qenë kryeredaktor. Mirëpo, mu më preferojshin ajo kllapa si me thonë ajo kategoria e njerëzve të kësaj natyre edhe në Zagreb edhe në Lublanë. Për shembull, po kalojmë prej fjalës në fjalë, unë në 50 vjetorin e shoqatës letrare të sllovenëve shkoj mysafir atje edhe e përshëndes në emër të shkrimtarëve të Kosovës shkrimtarëve shqiptarë edhe iu flas atyne në serbisht, vjen kryetari i shoqatës, që ishte edhe kryetar i akademisë sllovene kadale më thotë...

Pra e kishim fjalën te Takimi i Shekujve, ai film ishte bërë siç thash edhe me përpara me qëllim të tregohet përparimi që ka arritë Kosova mrena asaj kohe, do të thotë mrenda njëzet vjetëve, se '67-shin, njëzet vjetëve. Për me tregu se si është gjetë ky vend shumë i prapambetur, shqiptarët e sidomos janë paraqitë edhe si vandalë, si çka të thush. Njona prej atyne sekuencave të atij filmi ishte kur maja e xhamisë Sinan Pasha ne Prizren i bie freskës së Shën Petkes në manastirin e Shën Petkes në Prizren. Ai kishte për qëllim takimin e shekujve, domethënë kanë ardhë turqit ose tash turqi shqiptarë janë, edhe po i prishnin freskat që jonë një pasuri e madhe mesjetare serbe, trashëgimi kulturore.

Unë po e tregoj këtë për arsye se edhe ksi kishash ortodokse që jon quajtë serbe ka mjaft nëpër Kosovë, bile ka edhe nëpër vende ku nuk na merrë menja që munet me pas. Si për shembull, në Deviq të Drenicës, Drenica është krejt shqiptare atje është ni kishëgm ortodokse, ose në Mitrovicë në Boletin bash ne vendin e Isa Boletinit është kisha. Serbët i kanë vu kishat kudo që kanë shku, por ato që kanë vlerë sikur është kjo që e përmenda e Shën Petkës në Prizren, e Deçanit, e Graçanicës ato jonë ortodokse, por nuk jonë sllave. Pse nuk jonë sllave? Se përpara se me ardhë sllavët ktu kanë qenë fiset ilire të ndryshme që e kanë pranë krishterimin nja 30-40 vjet mas Krishtit, ndër të parët në Ballkan e kanë pranë krishterimin, jo pse kanë qenë të krishterë, ata nuk kanë dit çka oshtë krishterë po osht' ndërrimi. E tash në ato ndërrime bohen këso shkatërrimesh sikur jonë shkatrru idhujt për shembull, ose sikur jonë shkatërru bustet, sikur jonë shkatërru monumentet, ka gjana të këtilla. Por qëllimi ishte me tregu unë në këtë formë këto qashtje i trajtoj në kritikën time lidhur me këtë fe edhe ajo del në Vus edhe bënë bujë të madhe. Ministria e Informacioneve që oshtë si Ministria e Kulturës që ka edhe informacionin, bon një konferencë shtypi ku e akuzon artikullin tim por filmin e tërheqë, ai film nuk shfaqet mo për arsye se osht' tregu se autori i filmit ka qenë tendencioz edhe nuk ka qenë profesor as regjisor, e ku di unë. Mirëpo ajo sigurimi shtetëror ose sikur SHIK-u që ka qenë te ne këtu, sigurimi i inteligjencës i shënon këto gjana, kështu që unë kom hi ne listën e atyre të shënuarve, kjo ishte njo.

Mas disa kohe bohet një mbledhje këtu në Prishtinë, mbledhja e konferencës së lidhjes së komunistëve të Prishtinës, kjo ishte në '67-shin, tash në '69-shin edhe unë shkruaj nga qajo konferencë kryetar ishte Mahmut Bakalli. I'a tregoj Mahmut Bakallit artikullin thotë "Unë e kisha nënshkru që osht' mirë", mirëpo kur ai artikull del në "Vus" a e dini çfarë titulli merr, "Kush po mjellë

tradhëtira në Kosovë?” E tash unë kom qenë kundër mielljes së tradhëtirave sepse këto qenë kohërat kur na kemi fillu me marrë frymë pak ma lirshëm. Se jonë fut në burg ose jonë njëkë nga ata që i kanë njëkë shqiptarët vetëm pse jonë shqiptarë, ose oshtë ai aksioni i armëve ose aksione të ndryshme qe jonë bo.

E tash, kështu që unë tash isha në indeksin e sigurimit si njeri që tu qenë komunist po boj këso mrekullinash, e unë komunist jo prej dje po prej herët, unë në maj isha përjashtu po i'a kisha nisë në '42-shin. E tash edhe sot me thonë ktu komunist edhe pse jom përjashtu dy herë, e kom hi në burg, e jom shkarku disa herë, prapë se prapë me thonë komunist. Unë nuk kom qenë komunist, jo pse e mohojë komunizmin por nuk e njoh komunizmin, e për me qenë komunist duhet me i njoftë e duhet me ditë se a është i zbatueshëm. Kudo që ka fitu që e ka marrë pushtetin komunizmi si ideologji, si ideologji ajo ka dështu, oshtë e vërtetë që ka dështu.

Krejt merri të gjitha ato vendet ma komuniste që kanë mbetë si për shembull Korea e Veriut ose kjo e Kastros, Kuba. Pse? Se komunizmi nuk mund të realizohet se duhet me u ngritë vetëdija e popullit, por jo e disa njerëzve por e popullit mbarë, për me e ditë që secili duhet me punu aq sa mundet e me marr aq sa ka nevojë, por as me punu tepër me detyrim por as mos me marrë tepër. E tash kllapa, ata që janë udhëheqja ata që kanë mundësi, ata po marrin shumë e po krijohen divergjenca të mëdha të cilat qojnë edhe deri te shkatërrimi prandaj edhe nuk e ke zhvillimin. Tash këso forcash që u thashë unë, unë jom i vogël në krahasim me ta. Se populli i madh i jep edhe njerëzit e mëdhenj, populli i vogël sa do të mëdhenj më dhonë nuk mundet me dhonë për arsye se se ka ambientin që e rritë. Ju e dini ato edhe biologjikisht, senet e mëdha rriten në vendet e mëdha jo ne vendet e vogla.

E tash unë në '71-shin u bo kjo lëvizja që ju thashë, lëvizja masive në Kroaci edhe u përjashtuan plot udhëheqës, nga udhëheqja ma të naltë, t'u fillu prej sekretarit të partisë qysh e pat emrin kom harru nejse, ton njerëzit me te cilët unë kisha bashkëpunu në njëfarë mënyre. Mirë këtu njëherë më hoqën prej funksionit të redaktorit, e më qitën në prodhim gazetarë të thjeshtë për me fitu bukën me djersë e jo me funksion, se me funksion natyrisht nuk kishe nevojë mu djersit shumë (qeshë). Mirë kjo ishte në '71-shin kur u përjashtuan kta në Zagreb, te unë ndodhi mas pari në '69-shin, në '69-shin mas këtij artikulli që i'u thash “Kush po mjellë tradhëtira në Kosovë e këtu përmendeshin me emën Ali Shukriu, përmendej Jovo Shotra sekretar i partisë, përmendej Sava Perqenoviqi që ka qenë kryetar i komunës të Prishtinës, ambasador i Jugosllavisë në Tiranë, krejt me emër. Pra unë u konfrontova me udhëheqjen por ende i heshtur, pse? Gazetar i thjeshtë. Edhe tash ata prej Zagrebit më qitën në gjygj me këtë artikull, në ndërkohë kjo policia kufitare e Maqedonisë te Qafa e Thanës në kufi e ndali krejt kamionin me libra që vishin nga Shqipëria për Rilindjen, e ndër ato edhe librin e Dante Aligerit. [I drejtohet të pranishmeve] Ndoshta keni ndëgju për Danten është Komedia Hyjnore, e merreni me mend unë bëjë artikullin se qysh p'i nalin kta edhe ktu bohet një konferencë Ministria e Punëve te Brendshme e Maqedonisë organizon konferencë shtypi për me më rrëzu mu, edhe mu me padisin në gjygj, më qesin në gjygj në Rijekë qe Rieka ishte padrone, aty ishte regjistru kjo gazeta e Zagrebit.

Merreni me mend u botu shqip ktu kërkush kurgjo nuk boni zo, se nuk e lexojshin, kur u botu atje dola në gjygj. Nuk shkova në gjygj, e mur ajo vetë më mbrojti ajo shpija botuese që e kish botu librin, ajo e angazhoi avokatin edhe shkoi avokati në emër timin edhe në emër të asaj edhe nuk u bo kurgjo se ishte liria e shtypit atëherë. Mirëpo unë gjithë dimrin në indeks. Ata po thonë lënë Rilindjen se në Rilindje filluan me më ndjek, po unë ne Rilindje kur nuk kom shkru diçka që i ka bo keq Rilindjes se e kom ditë edhe jom pjekë pak, kom kalu nëpër do faza. Mirëpo jashtë Rilindjes kom shkru, jashtë mrrina m'u bo kryetar i shoqatës së gazetarëve një herë këtu, masnej anëtar i lidhjes së gazetarëve të Jugosllavisë, kisha atje delegacione midis gazetarëve vizitova Bashkimin Sovjetik, Gjermaninë et., etj. Krijova unë një rreth edhe jashtë Prishtinës, në Prishtinë ende nuk mu kishin lëshua në shpin, pritshin momentin.

E momenti erdhi. Kur erdhi? Momenti erdhi në '71-shin, jo në '72-shin, në '72-shin ajo që ndodhi në Kroaci në '71-shin po ndodhë në Serbi. Titoja vendosi me pastru edhe Serbinë, megjithëse e ka pas shumë të vështirë, unë them për Titon ka qenë një politikan ekuilibrist. E rrëzoi e likuidoi Kroacinë, udhëheqjen serbo-kroate për arsye se vetë ishte kroat. Kur i erdh rradha Serbisë e rrëzoi edhe Vojvodinën, tash u dufke me rrëzu edhe Kosovën. Kosova, kta shqiptarët ton që ishin në udhëheqje notojshin, e kur noton njeri e man ekuilibrin. E kush e han? E hajné peshqit e vegjël, peshqit e mëdhenj shpëtojnë, ndër peshqit e vegjël unë u gjeta. Edhe në '72-shin mu më përjashtojné prej partisë pse po shkruaj mirë për Shqipërinë. Unë as nuk po shkruaj mirë as nuk po shkruaj keq, po shkruaj qysh pe shoh, ose qysh po kom qef me pa. Osht' e vërtetë që kom shkru qysh kom pas qef me pa. Jom bo sekretar i shoqatës së shkrimtarëve të Kosovës e kom thirrë delegacionin e Shqipërisë në krye me Dhimitër Shuteriqin, ka qenë anëtar i presidiumit, ka qenë kryetar i lidhjes së shkrimtarëve por edhe ka qenë anëtar i presidiumit.

Kjo është '70-shi, për shembull kur vij te ky ansambli i kangëve dhe i valleve të Shqipërisë ktu bohej festë, sikur u bojke festë edhe kur lujke "Partizani" me Prishtinën për shembull, se kish nevojë ky popull me u shfry pak me diçka. E "Partizani" e kishte njëfar Jusufi që lujke futboll për shkak të Jusufit njerëzit bëheshin me klubin e "Partizanit" në Beograd që nuk kish lidhje por ishte Jusufi aty, ose qe erdh Prekazi, qe është e natyrshme nuk ndodh vetëm te shqiptarët ajo ndodh në krejt botën, por shqiptarëve ju shihet se gjithmonë kanë qenë të shtypun gjithmonë kanë qenë të okupuam prej të huajve. Tash në '72-shin unë përjashtohem edhe më hekin prej detyrës së gazetarit edhe më bojnë përkthyes, edhe përkthyes a e din qysh? Në këtë turnin e dytë, në turnin e fundit ai turni që fillonte ka ora tre- katër e përfundonte në gjysmë të natës, pjesën ma të vështirë. A e dini pse? Se kërkujshin me dhonë dorëheqje, unë nuk jepsha dorëheqje. Ajo Jugosllavia qashtu qysh ka qenë, po ka qenë shtet, nuk ka mujtë me të qitë prej punës nëse të ka kalu kontrata. Tash juve për shembull ju kalon kontrata shkoni në shpi, atëherë nuk ka mujtë, atëherë u dashtë me pas arsye për me të qitë prej punës ose ti me dhonë dorëheqje, ose me të detyru me dhonë dorëheqje.

Ka pas raste... Ka qene një rast po ju përmendi këta. Drejtori ka qenë, ai drejtori që ma ka uru ni

artikull që ka dalë në Vuz hala pa e pa unë, se e ka ble e ka pa. Qai njeri më ka kritikuar në mbledhje kur jom përjashtu prej partisë për qat artikull, mirëpo po e brente ndërgjegjja e po me thotë, “Pse bre ti kështu?”, shiqo i thashë, “Unë prej detyrës së portierit poshtë e deri te detyra jote jom në gjendje m’i kry, edhe e di unë që ti e din që unë jom n’gjendje m’i kry. Ato detyrën e portierit e kryej sepse osht’ punë e thjeshtë por edhe detyrën tonde kisha mujtë me e kry”, se e din ai qe muj. Thashë “Veç mos kujto qe jap dorëheqje, dorëheqje nuk kom me dhonë edhe pse më kanë propozu atje në Zagreb”. Hajde te na, rri në Prishtinë, rrogën e ki prej atjehit bile ma të mirë se në Rilindje.

E tash erdh koha kur, tash merreni me mend m’u ndalu paraqitja në Rilindje, jo vetëm në Rilindjen por krejt botimet që botoheshin në Rilindje. E Rilindja ishte shtëpi botuese që botonte edhe “Jetën e Re” ku për nja gjashtë vjet isha anëtar i redaksisë, ishte edhe “Fjala” ku bashkëpunoja me atë, ishin edhe krejt këto t’jjerat. Në asnjonën nuk kom pas të drejtë deri në ‘78-shin, gjashtë vjet nuk kom pas të drejtë me u paraqit me shkrime origjinale në gazetatat që botoheshin në Prishtinë. Mirëpo, nuk më kanë hekë nga redaksia “Sina” e Novisadit, ku isha anëtar i redaksisë edhe ku shkrujsha prapë për dramën edhe teatrin shqiptar, e kur flitsha për teatrin shqiptar flitsha për teatrin shqiptar krejt, jo vetëm për Kosovë, se na jemi një komb, shqip këtu shqip atje. Nuk shkrujsha për serbisht bile muj me ju tregu, qe atje nalt {dëfton nga rafti i librave} janë katër vazhdimë, qaty ndër të katërtat unë jom anëtar i redaksisë për letërsinë shqipe. Aty keni prej Bogdanit e Budit e motrave Qiriazit e deri te Ali Podrimja që ka vdekë para disa kohe, për Ali Podrimën muni me lexu aty shkruhet. Edhe nuk keni për serbët, edhe më kanë paditë pse kom shkru për shqiptaret, e nuk kom shkru për serbët. Po kom shkru për shqiptarët se unë e kom përcjellë literaturën shqipe, unë e kom përcjellë teatrin shqip, qe le të shkruajnë kta të tjerët. Ç’është e vërteta unë shkruj mirë serbisht.

E tash në këtë situatë unë meta, meta në redaksinë e Beogradit, meta në kryesinë e Lidhjes së Shkrimtarëve, pse? Në Lidhjen e Shkrimtarëve të Jugosllavisë kryetar ishte një kroat shkrimtar, në anëtar të kryesisë ishte një slloven, ishin teton [të gjithë]. Unë isha në emër të Kosovës, isha anëtar i jurisë së festivalit të punës në emër të Kosovës në vitin ‘72, por u zgjodha edhe në ‘80-shin, i përjashtuam. A e din pse p’e përmendi këtë? Se ka pas në Jugosllavinë e Titos së asaj kohe ka pas kuadro liberale, që nuk jonë ekstremiste, nuk jonë ideologjikisht të prishuna. Sikurse ka për shembull, edhe te na ka qasi rastesh. Te na për shembull ke në qoftë se je anëtar i Partisë Demokratike e kryetar i kuvendit osht’ i Partisë Demokratike ai të preferon, po në qoftë se je i Lidhjes Demokratike nuk të preferon edhe pse mundesh me pas kualitete për atë punë.

E ka pas raste për shembull, po ju përmendi këtë rast është një Jovan Çirilov nuk e di nuk keni ndëgju për të. Ai ka qenë drejtor i festivalit ndërkombëtar të teatrit në Beograd që quhet Bitef. Ai Bitefi është sikur tash që po i thonë teatri Alternativ jo ai teatri klasik që jep shfaqje si Shekspirin, Molerin por jep edhe Joneskon etj., etj., asi është ai Bitefi. Edhe unë isha anëtar i redaksisë, ai anëtar i redaksisë, por ai osht’ shumë i ngarkuam, osht’ nationalist serb, por nëse është nationalist serb mu nuk më pengon, në qoftë se nuk është shovinist. Se mundet me qenë edhe shovinist, e shovinist osht’ diçka tjetër, osht’

me urrejtë popullin tjetër, ai nuk ishte asi lloji. Edhe redaksia u dashke me bo vjet për vjet e bojshim nga një numër në anglisht për botën e jashtme, edhe po thonë me bo për tetarin në Kosovë. Por kur po thonë për teatrin në Kosovë ai nuk po thotë për teatrin shqip ose serb, por për teatrin në Kosovë. Unë thash, “Valla kom për teatrin në Kosovë, por kom për teatrin shqip në Kosovë”. (Qeshë)

Qyky Çirilovi që thash ishte nacionalist serb tha, “Po aq ma mirë, na duhet t’u tregojmë botës”, se dilke anglisht e një libër që dilke 300 faqe e njo 30 faqe ishin për teatrin shqip. Unë pi rrudhi krahët p’i thom, “Unë kom shkru për to, tash me marrë me shkru edhe një herë për serbët nuk muj se nuk e kom përcjell”. Ato për m’i përcjell duhet m’i përcjell në mënyrë kontinuitive, jo me përcjell njo sot njo nesër se edhe nuk kom shkru. E me insistimin e tij artikulli jem del serbisht, shqip kish dal në Kosovë edhe anglisht, edhe shkruan për filllet e teatrit shqiptar qysh në shekullin e kalum, jo në shekullin e XX por në shekullin e XIX. Krejt këto janë gjana që i përcjelli, merreni me mend në ‘72-shin kur më kanë largu mu prej partisë sekretari i punëve të brendshme ma ka marrë mu pasaportën. Jo vetëm që ma kanë marrë mu, por ja kanë marrë edhe gruas edhe djemve krejt. Krejt familja gjashtë vjet nuk kemi pas pasaportë, pa kurrfar faji. Mirëpo sekretari i punëve të brendshme i ka ato kanalet e veta edhe ai bon qysh don edhe i thonë edhe nifar urdhri administrativ, ai me urdhër administrativ shkel edhe ligjin edhe shkel çkado.

Metem te pasaporta, un pasaportën nuk e morra deri në ‘78-shin, në ‘78-shin Lidhja e Gazetarëve më caktoi delegacion me shku tash, kisha qenë në Gjermanin Lindore, tash me shku në Gjermani Perëndimore. Edhe thashë, “Unë nuk kom pasaportë”, ata i hapin sytë “E qysh nuk ki pasaportë?” (Qeshë) edhe tregoj që nuk kom pasaportë. Edhe ma nxjerrin pasaportën, ma japin pasaportën atëherë krejt familjes në ‘78-shin kemi pas pasaportë derisa ka ardhë koha. Çfarë anomalie, ju ndër kohë ne qarqet letrare, artistike, kulturore ju keni vendin tuaj, e në shpi tonën, vend tonin ta marrin edhe pasaportën, jo ty po ja marrin edhe gruas e djalit edhe krejt. E ne jse tash për mos me zgjatë gjatë gjithë kësaj kohe unë ton kohën jom marrë me punë letrare, artistike. Kom shkru për teatrin, e kom pas çdo shfaqje që oshtë dhonë sonte, nesër e kom shkru, pasnesër ka dalë në gazetë. Gjatë kohës sa kom qenë në radio, sonte e kom pa nesër natje e ki pas recesionin, ton kohën kjo ka zgjatë deri sa kom qenë gazetar aktiv. Edhe masi jom largu tashti, se në ‘72-shin u largova nga aktiviteti deri në ‘81-shin , e në 81-shin e kom lonë krejt, në ‘81-shin kur u bon këto demonstratat. Pse e kom lonë? Se unë e disha që kisha hala kapacitet, ‘81-shi është para 30 vjetëve, e unë edhe gjatë këtyre vjetëve që jom në pension, e jom në pension prej ‘81-shit, unë ton kohën jom aktiv, ende tash jom aktiv.

Tash unë vazhdova të punoj në fushën që njihja, përkthejsa shqip, përkthejsa serbisht, por tash me një drejtim tjetër kryesisht letërsi, teatër film. M’ka me shkru, m’ka ra me organizu javën e filmit shqiptar në Prishtinë diku në vitin ‘70 ose ‘71, nuk po e di edhe për çdo film që o’ dhonë kom shkru të nesërmën menjëherë. Ajo nuk i’u ka fletë mirë këtyre, se unë kom shkru në mënyrë afirmative, është e vërtetë. Aq është e vërtetë, saqë kta punëtorët e filmit në Shqipëri i kanë pre gazetatat edhe i kanë vu si ekspozitë. S’kanë guxu me shkru vetë atje, ka qenë atmosferë tjetër. Te na vitet ‘70 ka qenë diçka

tjetër, nime në '72-shin u përjashtova por deri atëherë edhe masanej unë prapë kom vazhdu. Në '80-shin kom qenë anëtar i jurisë së festivalit në Pulë me karakter jo vetëm Jugosllav por edhe ndërkombëtar, edhe kom shkru për krejt këto. Por qëllimi jem, e jo vetëm i jemi, po sidomos i redaksisë sonë, i redaksisë Jeta e re ku unë kom qenë anëtar i redaksisë... merreni me mend kom qenë i zgjedhur anëtar i redaksisë në '54-shin, sa p'i bjen 50 e kusur vjet përpara, kryeredaktor ka qenë Esad Mekuli, që thotë Ramiz Kelmendi "Të gjithë kemi dalë prej mëngës së tij". Na nuk kemi dalë prej mëngës së tij për arsye se unë kom qenë afërsisht me moshë kom qenë afër tij, por ai ka qenë shumë njeri i mençur edhe e ka ditë që populli i ynë duhet të afirmohet me vlerat e veta. E vlera jonë vlera atëherë kur cilësohen jo vlerat, kur nxihen jo vlerat, kur kritikohen jo vlerat, e kur preferohen vlerat.

E na jemi përpjekë me qitë vlerat, për shembull unë kom para vetit qitash, unë kom botu në gjuhën serbe "Kështjellën" e Kadaresë edhe e ka botu Noliti i Beogradit. E ka botu Jedinstvo e Prishtinës, por Noliti edhe që ka qenë një shtëpi botuese me nam edhe sot është. Edhe e kom zgjedhë bash Kështjellën e Kadaresë. E kom botu "Kronikën në Gur" te Kadaresë e ato e kom botu në Sarajevë. E kom botu "Dimrin e madh" të Kadaresë këtë në Zagreb. Kqyrni {numron në gishta} Beograd, Zagreb, Sarajevë tri qendrat. Kom folë për... Ali Podrimja e ka bo bashkë me nifarë Jakuvo Skoti një antologji të letërsisë shqipe në gjuhën kroate por të përkthyme në italisht, edhe u botu në Rijekë në italisht, unë e kom bo parathanien. Ajo ka qenë kontakti i parë edhe i Ali Podrimjes si poet, por edhe i letërsisë shqipe me një gjuhë perëndimore. Italishtja gjuhë perëndimore pa marrë parasysh pse ishte italishte e Rijekës por perëndimore ishte. Edhe kjo ishte diku në vitet '60-ta, s'di cili vit nuk e maj n'mend e kom dikund atë libër.

E kom botu në Novisad romanin për fëmijë të Vehbi Kikaj "Sarajet e Bardha" është njo prej librave të letërsisë shqipe ndër ma të mirat e kom botu serbisht. E u marrë ka hy edhe si lekturë shkollore "Sarajet e Bardha" jonë lexu edhe jonë dhonë nga fmitë edhe në sllovenisht, edhe në boshnjakisht, se lekturë shkollore, lektyra shkollore ishte e përbashkët. Ishin ato bërthamat e përbashkëta që i kishim pas bo. Mandej, e kom botu poezi te Ali Podrimës "Në Zotin hetuan gjarprin" përmbledhje e poezive edhe kto e ka botu Noliti i Beogradit. Merreni me mend ne këtë përmbledhje "Në Zotin hetuan gjarprin" në Beograd nuk është botu shqip, a e dini pse? A e dini Zoti kush është? Zoti është kryetari i krejt botës, por Zoti është edhe Tito. (Buzëqeshë) Në Zotin pra në Titon e hetuan gjarprin. Ktu nuk shkrun në Titon e hetuan gjarprin, shkrun në Zotin e hetuan, po ju qe dini me lexu pak në qoftë se dini, ju muni me e lidhë menjëherë çka ka dashtë me thonë. Kta e ka botu në serbisht e e kom përkthye unë në shqip krejt librin. Merreni me mend kjo vjershë e Ali Podrimës osht' botu ktu te na por jo libri, e ktu nuk është fjala vetëm për... libri ka edhe vjersha t'tjera.

Merreni me mend për Ali Podrimën kom shkru qe qaty jonë katër vëllime, por është edhe një vëllim qëtu e kom diku, nuk ka nevojë me ju tregu por po ju them kështu që e ka botu Matica Serbska. Matica Serbska osht' një organizatë letrare që botohet në Novisad edhe ka karakterin e akademisë. Se Vojvodina ka qenë shtet para Serbisë, shtet në kuadrin e Austro-Hungarisë ka qenë prandaj ka mbetë

qysh ka mbetë. E osht' njëfar Milisava, osht' njoni prej akademikëve ma të vjetër të Serbisë, e ka botu Ali Podrimën. E pra unë po ju përmendi këtë që qëllimi ynë ka qenë me afirmu, jo i jemi po i krejt ekipës së Jetes së Re. E na ekipi i Jetës së Re në kohën kur kom qenë unë, kryeredaktor ka qenë Esad Mekuli, anëtar i redaksisë ka qenë Zekerija Rexha që ma përpara ka qenë edhe drejtor i shtëpisë kur u formu ajo. Ka qenë Tajra edhe unë, katër vetë, qata katër me qat fuqi që kemi pas jemi mundu. Shihe un i'u përmenda këto por Sarajeva për shembull ka botu edhe përmbledhje të tregimeve shqiptare që quhet "Gjurmimet" serbisht "Traganja" prapë në përkthim timin, po në përgatitje bashkë me Rexhep Qosen, Rexhepi e ka bo edhe parashenjën. Romanet e Anton Pashkut "Oh", Ibrahim Kadrijut "Koha e Ilaçit", të Rexhep Zukajt "Dhuna", të Rexhep Hoxhes "Lugjet e verdha" noshta e keni lexu, të Vehbi Kikaj e përmenda "Sarajet e bardha" etj., etj. Pra kjo periudhë e punës sime prej '72-shit osht' zhvillu ma tepër në këtë teren.

Unë nuk jom marrë mo me këto punë deri në vitet '80 kur u hoq autonomia e Kosovës, atëherë unë jom njeri prej nënshkruesve të apelit të 215-ve ndoshta keni ndëgju, ai është apeli kur kemi dalë botënisht në shtypin Jugosllav kundër heqjes së autonomisë së Kosovës et., etj. E tash kom fillu me u marr edhe me politikë aktuale, qysh?

Në '89-shin e kemi formu, mas qëtij apeli, apeli ka qenë në fillim të '89-tës diku në shkurt të '89-shit, kurse në nëntor të '89-shit na e kemi formu Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. E qaj Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ka përcjellë krejt ngjarjet që ndodhën në Kosovë edhe i ka publiku shqip, i ka publiku serbisht, i ka publiku anglisht edhe kanë shku prej Kosovës në krejt botën, edhe ju kanë shku edhe personaliteteve t'u fillu prej Kofi Annan, ktyne në Jugosllavi Ante Markoviç-it etj., etj. E tash në këtë kohë në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave unë kom qenë nifar shefi i shërbimit informativ, edhe na kemi nxjerrë 29 numra të buletinit me krejt këto informacione çka u bo, me krejt komentet tjera, jom angazhu edhe në shoqatën e veteranëve.

Anita Prapashtica: A mundesh diçka ma gjerësisht për Këshillin me na fol?

Vehap Shita: Na e kemi formu Këshillin si të parën organizatë pluraliste që i thojshin në atë kohë, që filloi një farë pluralizmi mbas këtyre masave që u morën në krejt Jugosllavinë. Kryetar ka qenë Idriz Ajeti mas pari, mandej mas Idrizit ka qenë kryetar Bajram Kelmendi; ka qenë kryetar Adem Demaqi edhe ka qenë kryetar edhe osht' edhe sot e kësaj dite, se këshilli praktikisht ekziston në letra hala por me aktivitet osht' kufizu ma tepër te drejtori ekzekutiv edhe te ai stafi që punon aty, kurse na kemi punu si bord, e ka qenë Pajazit Nushi që edhe sot osht' si kryetar. Na në këshill ç'është e vërteta është bënë një punë shumë e madhe sepse njëherë mas pari ka qenë i formum prej ajkës së intelektualëve të Kosovës, t'u fillu prej Ibrahim Rugovës e deri te Vehap Shita, (qeshë) na kemi qenë themelues. Kurse i ndjeri Zekera Cana që ka qenë sekretar edhe që ka qenë njoni prej pionierëve të Këshillit që ka vrapu edhe për apel, se edhe për apelin ka osht' ai që ka shku shpi në shpi, se nuk ka qenë pinë e vogël me nënshkru apelin. Apeli ka qenë kundër Millosheviqit edhe mas pesë ditëve osht' formu Lidhja

Demokratike. Pra na me 14 kta me 19 e kanë formu Lidhjen Demokratike. Në Lidhjen Demokratike kanë qenë krejt njerëzit e redaksisë së kulturës ku unë isha redaktor, t'u fillu prej Jusuf Buxhovit që u bo sekretar, Mehmet Krajës, Musa Ramadanit, Xhemajl Ahmetit që u vra. Pra ajo pjesë e intelektualëve që ekzistonte në Kosovë e tubume rreth Rilindjes edhe rreth Akademisë së Shkencave, besa edhe rreth Institutit të Historisë megjithëse ma pak. Instituti i Historisë na ka ndihmu shumë në kohën e luftës, por nuk ka pas shumë, se shkoj shpejt, e likfidun atë Ali Hadrin që ishte edhe në krye të institutit por edhe kishte kapacitet për me i nejtë përballë situatës në të cilën ndodheshim. Mirëpo Akademia, Rilindja, Instituti Albanologjik krejt këto u tubun në këto dy organizata, na qe kemi qenë në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut o' dashtë me qenë jashtë partive, se fillun të formohen edhe parti tjera. Se Lëvizja Demokratike ishte Lëvizje Demokratike nuk ishte Lidhje por e mori emrin Lidhje për me i ngja Lidhjes së Komunistëve, se atëherë kishte me qenë lëvizje gjithë popullore jo me përcaktime ideologjike, edhe nuk kishte nevojë. Sikurse u pa që nuk ka qenë mirë, praktikisht kur fillun partitë tash u bënë tridhjetë parti, ajo Amerika po ekziston me dy parti, na dymbëdhjetë s'po na dalin (qeshë).

Edhe kështu në kësi situatë na pra ky Zekeria Cana, Avni Spahiu edhe unë kemi fillu me i bo informatat ditore për ngjarjet në Kosovë. Prej informatave ditore fillum me i bo javore, ajo javore i përfshinte ngjarjet e krejt javës edhe ato shpërndareshin, por u bënë shumë efektive ato, se ja qojshim edhe ka qenë një ministër i informacionit në Këshillin Ekzekutiv Federativ ajo ka qenë një hungareze. Ajo filloi me na kritiku neve, me kritiku këshillin, jo neve personalisht se na nuk nënshkruheshin. Bile në një rast Idriz Ajeti ishte kryetar, "Une nuk di kurgjo" tha, e i thash "Valla ti din na ty po t'nenshkrujmë. (Qeshë). Në qoftë se na kap dikush ty të kapin". (Qeshë) Veç i mirë ai Idrizi, nuk ka qenë njeri që shtyhet, veç u bo kryetar i parlamentit ilegal, i thash "Ti prej kryetarit të këshillit u bone kryetar i parlamentit". E na prej këshillit jo vetëm këto informata që po i' flas, por vishin edhe delegacione të ndryshme ndërkombëtare bojshin vizitë, ata që e vizitojshin Ibrahim Rugovën vishin edhe te na. Ata që e vizitojshin qeverinë që ishte në fuqi vishin te na, ai përgjegjësi që ka qenë për të drejtat e njeriut për Evropën vijke te na. Fillun besa edhe me na ndihmu këto të jashtmet, na ndihmuan financiarisht, se na punojshim po nuk ishim në punë, na përjashtuan krejt kërkush kurgjo nuk kish. (Qeshë)

Filloi me u zhvillu puna, e delegacioni jonë ka qenë në Gjenevë te komisioni për të drejtat e njeriut, komisioni ndërkombëtar edhe ka qenë nënkomisioni. Qaty në nënkomision na merrshim pjesë, por na nuk kishim të drejt vote, a e dini pse? Neve na thanë me u bo anëtarë të komitetit të Helsinkit në Beograd, na nuk dojshim, dojshim me bo ktu në Kosovë tonin por jo në Beograd. Na metëm përjashta, ndërkohë u formu në Kosovë komiteti i Helsinkit por prapë si anëtar i Beogradit në krye me Gazmend Pulën. Ai nuk zhvilloi ndonjë aktivitet për arsye se shqiptarët tonë krejt çka ishte me Serbinë nuk e dojshin ç'është e vërteta, ishte një bojkot i heshtun, s'guxojsh me thonë që po bojkoton, por bojkot ishte. Tash në Gjenevë në këtë nënkomisionin për të drejtat e njeriut në Gjenevë na qojshin delegatët tonë, këta nuk mund të paraqiteshin si të pavarur se nuk kishin të drejtë vote, por na u bëmë si anëtarë të Federatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut me seli në Paris, edhe në emër të asaj

FDA-së na tash paraqiteshim. Edhe aty zakonisht shkojshin aktivistët tonë që dinë gjuhë të huaja, u dashke mi ditë bile frëngjisht në qoftë se jo anglisht, po ka deshtë Zoti kishte të këtillë. Për shembull ishte Zejnullah Gruda që ka qenë ambasador i Jugosllavisë në Panama diku në Evropën Latine, ka qenë Ymer Jaha që e ka përgatitë doktoraturën në Paris, ka qenë Ibrahim Rugova që ka ditë frëngjisht, skuadra nuk kemi qenë krejt dudukë [teveqelë].

Na që kemi studiu në kohën e Jugosllavisë, unë di mi përdorë tri gjuhë të huaja frëngjisht, italisht dhe gjermanisht, me asnjonën s'di me folë, se qashtu kemi msu, kemi msu mi përdorë në literaturë. Në shkollë të mesme i kom pas pesë gjuhë të huaja ku mundesh m'i msu, ndër ato edhe arabisht edhe turqisht merreni me mend. E msojsa nga një vjershë përmendësh (Qeshë) e merrsha nga një tresh sa me thonë. Por, kishim intelektualë muj me ju përmend nëse doni. Qaty unë kom qenë kryeredaktor i kemi nxjerr 29 numra, 29 numra ka 150-200 faqe, krejt qato unë i kom redaktu, i kom lektoru, i kom përkthi serbisht edhe ju kom dhonë stafit me i përkthi anglisht, kemi pas dy përkthyes shumë të mirë anglisht.

Autoritet ktu por ka pas autoritet edhe përjashta, për arsye se është jashtë partiak, është i përbam prej kryesisht intelektualëve jo kryesisht por krejt prej intelektualëve, ajo ajka e intelektualëve ishte aty. Ç'është e vërteta me ardhjen e Adem Demaqit për kryetar këshilli filloi me u zgjanu edhe në terren, sepse u dashtë dikush prej trenit me na njoftu për ngjarjet atje. E natyrisht atje nuk kishin profesorë e doktorë kishte njerëz, por punë shumë të madhe ka bo nënkëshilli jonë në Mitrovicë në krye me Halil Bajramin. Ai ka qenë njeri i cili ka depërtu shumë, osht' çudi qysh ka shpëtu gjallë sepse e kanë përcjell, por ka shpëtu, ka qenë edhe i aftë. Mirëpo çdo gjë që ka ndodh në Mitrovicë, se shumë gjana kanë ndodh në Mitrovicë edhe sot po ndodhin, ai i ka regjistru të gjitha. E ka bo librin ma të madh se na edhe pse na kemi qenë ma kështu... (qeshë) po kështu ka qenë ai njeri vullnetar. Krejt familjen e ka angazhu, ai ka qenë njeri për hesap timin sikur ata proletaret që jepen me ka krejt mas punës, një pune që marrin.

Mirëpo këshilli brenda ka bo analiza të ndryshme të gjendjes, ka bo propozime, ka bo takime, kanë shku njerëzit tonë në emër të këshillit kanë shku përjashta kanë shku në Amerikë, kanë shku në Francë, kanë shku kudo. Kështu që besa, Elizabeth Rain ka qenë një përgjegjëse për të drejtat e njeriut në kuadrin e OSBE-së [OSCE] ose të këshillit evropian, ose ai Mazovietski ai ka qenë polak por edhe ai ka qenë raportues i këshillit për të drejtat e njeriut në rangun evropian. Mandej ka qenë Federata e të Drejtave të njeriut në Paris e cila i ka marrë rregullisht informatat tona, krejt materialet çka kemi bo. Të gjitha kanë shku përjashta, krejt kjo punë osht' bo tu qenë Millosheviqi në pushtet. Jonë burgos njerëzit tanë për shembull, osht' burgos tash ka vdekë ka qenë gjeneral nji Shaban Shala tash para një viti vdiq, ka qenë nënkryetar i këshillit e kanë burgos, e kanë rrahë për me tregu çka po bojme na, qysh po bojme na. Ky ka tregu po na krejt punët legalisht po i bojme s'ka pas nevojë me rrahë hiq se nuk kemi bo kurgjo në mënyrë të fshehtë, krejt çka kemi bo i kemi qit përjashta edhe ato kanë mujtë me i shënu ky sigurimi krejt me mjete elektronike, ose edhe jo elektronike jonë ndëgju. Për shembull mu

kanë ardhë më kanë marrë policia në shpi a e dini për çka, me kanë lyp armë. Ka ardhë shefi i policisë në derë, une “Urdhëroni?”, “A jeni ju Vehap Shita” “Po”, “A keni armë?” “Jo” thash “unë kom qenë partizan kur me kanë burgos, m’i kanë marrë krejt”. Edhe përnime m’i kishin marrë krejt, masnej s’i kom marrë se nuk kom ditë m’i përdorë asnjonën.

Më kujtohet një here jom rruzu bashkë me pushkë. (Qeshë) Thash unë kom armë dhe e nxora lapsin kjo asht arma ime, me shkru di, shkruan edhe gazeta masnej “E kanë burgos se e ka tregu lapsin”. Thash “Hajdeni mrena kom plot”, e kisha nime krejt materialin, e kisha kompjuterin e këshillit në atë kohë krejt i kisha të shkrome, por disketat, gruaja jeme kur fillun bombardimet i ka marrë krejt disketat qaty i kom hala. I ka pështjell në kavanoza, e kavanozat i ka futë në lule, jo në lule po i ka grupu dheun e ka shti kavanozin. E ka qitë përsipri, e përmby dheut i ka qitë lule edhe ato kanë shpëtu deri kur kanë ardh KFOR-i. Kur kanë ardhë KFOR-i kanë ardh ekipi i CNN-it e ka fotografu ato edhe gruan time tu i nxjerr ato prej kopshtit, kjo ishte improvizim, se ato disketat i kishim nxjerr ma herët. Kështu që këto krejt janë regjistru prej ‘97-shit, ‘98, ‘99. Prej ‘97-shit i kemi pas krejt të kompjuterizime edhe krejt në disketa edhe krejt në kompjuter, edhe nuk e kom hekë kompjuterin edhe në kohën e luftës.

Anita Prapashtica: Zoti Vehap na tregoni për aktivitetin tuaj gjatë luftës në Kosovë.

Vehap Shita: Unë i kom përjetu dy luftëra, e luftën e fundit, gjatë tërë luftës kam qenë anëtar i këshillit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe aty kom krye detyrën e shefit të shërbimit informativë Unë konsideroj se në luftë me Serbinë, në luftën e fundit na jemi prej vitit 90, prej korrikut 1990 kur arbitrarisht Serbia e ka anuluar autonominë e Kosovës, në atë kohë unë tash më kamë qenë në këshillin për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, ku kamë qenë anëtar prej fillimit dhe kom qenë njëkohësisht nifar shefi i shërbimit informativ, e ky shërbim informativ prej prillit të vitit 1990 e deri më 1 korrik 2005 ka regjistru çdo aktivitet çdo veprim kundër të drejtave të qytetarëve të Kosovës, natyrisht në radhë të shqiptarëve të cilët kanë qenë te okupuar, praktikisht kanë qenë të okupuar nga Serbia dhe nga pushteti paramilitar, militar dhe ushtarak serb. Kjo kohë më ka gjetë mu në këtë detyrë, në fillim kom punu pakë edhe në Lidhjen Demokratike të Kosovës por në këshill u more qëndrimi që na që jemi anëtar të këshillit e sidomos na që jemi anëtar të kryesisë edhe që e udhëheqim punën aktive në këshill, të mos jemi anëtar të partive politike, kështu që unë gjatë tërë kësaj kohe deri në fund, edhe pas bombardimeve të NATO-s unë kom vazhduar atë aktivitet duke mbledh shënime, duke mbajtur udhëheqjen e Boletinit, Boletini i këshillit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut për të cilin pak ju kom fol edhe para kësaj here, deri më 1 korrik të vitit 2005 ka botu 29 numra, e në ato numra që kanë mesatarisht 200 faqe, e janë botuar në shqip, serbisht edhe anglisht, anglisht i ka përkthyer tjetër kush, unë i kom përkthyer në serbisht, kështu që aktiviteti im ka qenë i përqendruar këtu, edhe gjatë tan kësaj kohe unë kom nejt në Prishtinë edhe kur ka fillu bombardimi. Tash gjatë bombardimit kanë ardh disa herë policia serbe, por ime shoqe i ka fsheh të

gjitha disketat në të cilat kanë qenë shënimet për të cilat ju fola, edhe i ka qu në kopsht, e kemi një kopsht të vogël këtu mbrapa jush, në dhe i ka mbulua me dhe, i ka vu lulet përsipër kështu që ato kanë shpëtu dhe na kemi bo një punë të madhe menoj, ma vonë ju tregoj, se ma vonë mas shënimit kemi botu një libër të madhë me 1000 e disa faqe ku jon regjistru krejt këto, po atu jon regjistru edhe emrat e te vrarëve, të pushkatuarve, të torturumve mandej masakrat masive që jon bo në çdo vend, në Izbic, në Likoshan, në Prekaz etjera etjera. Jon regjistru edhe të burgosurit që i kanë marrë me veti serbet kur jon tërheqë prej ktuhit, pak përpara se të tërhiqeshin, kemi pas emrat e të gjithëve. Kështu që na, mendoj këshilli jonë edhe Boletini të cilën e kom udhëheqë unë si kryeredaktor, qysh në qershor, korrik të 99-shit ka dal me listën e të vrarëve, të pushkatuarve, të burgosurve, të zhdukurve natyrisht ato që kemi arrit ti regjistrojmë deri atëherë, më vonë kemi regjistru edhe hulumtimin ose kërkimin nëpër teren për ti plotsu ato lista, por ato që kemi pas në qershor të vitit 1999, ka qenë dokumenti i parë më autentik për atë çka është bo brenda asaj kohe. Kështu që veprimtaria ime gjatë luftës ka qenë e përqendruar këtu, por ndërkohë na e kemi organizu edhe tubimet e ndryshme, në të cilat është informu opinionin te na këtu në Kosovë, por edhe jashtë, shembull një tubim tjetër kemi pas edhe në Zagreb ku kanë ardh të gjithë këta përfaqësuesit e këshillave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të republikave, të krahinave, të ish Jugosllavisë aty kemi mbajt ligjërata, me dhënë informacione për ngjarjet që po ndodhin në Kosovë, ajo ka qenë pjesë e punës sonë. Ktu kanë marrë pjesë personalitete të Kroacisë së atëherëshme, Kroacia ka qenë nifar dore pushteti që i majshin ata, kanë qenë kjo partia e Dujzmanit që e mante pushtetin , ka qenë mik me ne por ka punu me na shti edhe në lufte, ajo është punë e tjetër kujtë jo punë e jonë, na në luftë direkte me Serbin me front nuk është hapë, deri me paraqitjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me paraqitjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, na kemi majte lidhje me ushtrinë, shembull nënkryetari ynë ka qenë edhe gjeneral i ushtrisë, por ka qenë legal si Shaban Shala, tash ka vdek, kjo është në kohën e luftës. Në kohën e luftës një aktivitet i yni që ka qenë shumë me rëndësi ka qenë takimi me këshillat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të republikave dhe krahinave të asaj kohe në Sarajeve, ku jemi paraqit na vetë me kumtesa, kom pas edhe unë kumtesë por kemi pas edhe ekipin e avokatëve në krye me Bajram Kelmendin të cilin e ka likuidu Millosheviqi në natën e parë të bombardimit, bashkë me të shoqën Nekibe Kelmendin që pas lufte ka qenë edhe ministre e drejtësisë, si një familje shume aktive, patriotike, e cila ka dhënë shumë gjatë luftës. Natyrisht edhe unë si funksionare i këshillit kom qenë i inkuadruar tërë kohën në ato veprime. Të ju them edhe një aktivitet ndërkombëtar, se neve në këshill na ka vozitu Mozovietski që ka qenë i Ozbis për të drejtat e njeriut etjer, ata janë informu për këto çka po ndodh në Kosovë, informatat kanë qenë të rëndësishme sepse ato e kanë senzibilizu opinionin evropian edhe botërore e sidomos opinionin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës edhe ato kanë sjell deri te situata, se ata të shohin se nuk kanë të bëjnë me grupe diversante por në një anë me ushtri të rregullt, e në një anë me njerëz që intelektual, udhëheqës të partive politike por edhe janë aktivist për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Po ju them këtë për arsye se atëherë ky këshilli ynë është bërë faktor kryesor për informimin e botës për atë çka po ndodhe këtu, pra aktiviteti im personal ka qenë i përqendruar në këtë fushë. Ne kemi botu edhe fletushka, botime në anglisht, natyrisht anglishtja ka qenë që na ka afrua me botën krejt edhe

ato i kemi botu me emër, me mbiemër edhe kanë mujt me na marrë, por kanë fol shumë kundër nesh, nuk kanë mujt me na qitë direkt në gjygj, sepse këshilli ynë ka qenë edhe anëtar i federatës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut me seli në Parisë, ajo ka qenë federatë ndërkombëtare, nuk kemi qenë anëtarë të komitetit të Hilsingit, për arsye se atëherë Unioni Evropian kërkonte që të bëhemi anëtar nëpërmjet komitetit të Hilsingit të Serbisë, na nuk e kemi pranuar por e kemi gjete një mbështetje në Francë, edhe me ju thënë të drejtën ne kemi qenë faktor i cili na ka afru me perëndimin edhe me Anglinë edhe me Amerikën edhe me Francën që përherë kanë qenë krahë Serbisë, hera e parë që ne në këtë luftën e fundit po dalim aleate me Shtetet e Bashkuara, me Francën, me Gjermaninë. Përveç kësaj na jemi përpjekë edhe në kohën e luftës, unë e konsideroj luftën e 98-shit jo vetëm kohën e bombardimeve, 98-shin na kemi pas një takim me përfaqësuesin e qeverisë së Serbisë për Serbia me i njoftë vendimet që i ka marrë parlamenti i Kosovës për të drejtën e Kosovës si njësi federale sikur Serbia, sikur Mali i Zi, si Kroacia, Sllovenia, e kemi mbajtur nuk kemi mujt me mbërriri marrëveshje në atë mbledhje. Në atë takim me përfaqësuesit e Serbisë në emër të Kosovës ka marrë delegacioni jonë, delegacioni i këshillit, ka marrë delegacioni i Lidhjes Demokratike, Delegacioni i Ujdisë ka qenë ajo partia e Veton Surrojit edhe udhëheqës i Delegacionit të Serbisë ka qenë Tomislav Nikolici, është shumë interesant që Tomislav Nikolici atëherë ka qenë me partinë e Sheshelit, kurse nga ne, në udhëheqje të grupit tonë ka qenë i ndjeri Bajram Kelmendi të cilin e kanë vra kta pas luftës, ka qenë Pajazit Nushi.

Ka qenë i ndjeri Fehmi Agani, Fehmi Agani ka fol edhe nënkryetari i qeverisë serbe ka qenë një jurist profesor i universitetit të Beogradit, ekspert i të drejtës kushtetuese nuk po me kujtohet emri, e po e përmendi këtë fakt se jon konfrontu me të drejtën e Serbisë për me tërheqë vendimin për supermimin e autonomisë, edhe në atë bisedë ju ka përgjigj Bajram Kelmendi që ka qenë një jurist i fortë por ka qenë edhe një orator shumë i mirë, në të gjitha këto botime unë kom marr pjesë si kryeredaktor i Boletinit por edhe si përkthyes nga shqipja serbisht edhe nga serbishtja shqip, për arsye se secili prej nesh, shembull Fehmi Agani e ka krye fakultetin në Beograd e ka ditë serbishtën por në bisedë me Tomislav Nikolic-in ka fol shqip për me mujt me tregu se gjuha shqipe është ktu zyrtare sikurse që ka fol edhe ai në gjuhën e vet. Prandaj në njëfarë mënyre jemi përpjek me e vërtetu identitetin tonë si shqiptarë edhe si pjesëtare të një komuniteti i cili ka qenë i barabartë me komunitetet tjera. Kjo ka qenë koha e paraluftës është 98-shi diku maji i 98-shit, mas ngjarjeve të Prekazit kur u acarua situata krejt, kur rreth 200 mijë shqiptarë të viseve të ndryshme të Kosovës kanë qenë të dëbuar nga familjet e tyre nga vatrën e tyre, e kanë qenë në malet e Drenicës, në malet e Dukagjinit, kanë qenë në një situatë shumë të keqe, pra kur Kosovës iu është kërcënu katastrofa humanitare, katastrofa humanitare nënkupton vdekjen nga uria, vdekjen nga të ftohtit, vdekjen nga pushkatimi nga vrasja krejt këto. Ato na tu i përcjell e kemi sjell situatën që të vijë kjo kryetarja e komitetit për të drejtat e njeriut, të vije edhe ti vizitoj këto vende ku kanë qenë të strehuara këto familjet tona. Pra ky ka qenë një aktivitet i përgjithshëm, këtu në shtëpinë time më kanë ardh aktivistët e këshillit mi kanë pru ato informata që kanë ardh nga terreni, unë i kom përpunu i kom rregullu, i kom përkthi në gjuhën serbishte, i kom

përcjell, krejt kanë ardh në këtë dritaren që po shihni këtu, kanë ardh shembull Linka, ka ardh kjo që është tash ambasadore Mimoza Ahmeti tjera tjera, natyrisht kanë ardh femra se ma pak bishin në sy. Në Mars të 99-shit pak përpara bombardimit një oficer i CIA-s erdh edhe më ka njoft mu, jemi njofto me të edhe ka lyp me u taku me Adem Demaqin si përfaqësues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe me Fehmi Aganin si përfaqësues i Lidhjes Demokratike, jo me Ibrahim Rugovën se Ibrahim Rugova ishte në kullën e vet e nuk guxonte me dal se përcillej natyrisht, është përcjell edhe Fehmi Agani e kanë ditë ata por pak ma ndryshe. E bash në këtë dhomë janë takuar herë me njërin, herë me tjetrin, kur i kemi përcjell këta mas bisedës me Adem Demaqin na kanë thënë tash mbahuni, ikni prej ktuhit se po kris lufta, pra ende pa ja nis bombardimi nja dy-tri ditë përpara nuk mundem me thënë tamon a kanë qenë dy-tri veç jo ma tepër na kemi ditë që po bohët intervenimi.

Ju ndoshta thjesht se keni ditë ju keni qenë të reja, por na e kemi ditë se çka po bohet se ai ka thonë bahi, na nuk jemi bajt, djali që kom në shpi nuk ka dashtë me ikë e me na lon neve vetëm, na e kemi lut me shku se kemi qenë në rrezik se kemi qenë të njoftun, mu më ka marr policia përpara se të ndodhte kjo, por interesant nuk e di a ju kom tregu policia ka ardh edhe më ka marrë për armë, unë armë nuk kom veç kom ni armë edhe e kom nxjerr lapsin kjo është arma ime që shkruaj, urdhëroni shihni kom plot materiale, nuk mujsha me i mshef materialet sepse ata e dishin që prej ktuhit po shkojnë lajmet edhe informatat edhe nuk i mshefsha, ajo që ju tregova kemi mshef në kohën e luftës, kemi mshef prej frikës që po na zhduken se kanë ik njerëzit, se për ndryshe nuk i kemi mshef, më murrën në polici më majtën nja 2 orë atje qështë e vërteta nuk më kanë prej me dorë, vetëm tu më dhonë zorë me sjell armën që nuk e kisha e përnime nuk e kisha ata më thanë gjithë këta kanë thonë që nuk e kemi por mandej e kanë sjell, do të thotë e kanë sjell kur i kemi torturu, kjo ka mju gjetë edhe juve. Mu nuk më gjeti se nifsha që jomë prej këshillit e sidokudo. E prej këshillit përndryshe jon burgos ky që ju përmenda Shaban Shala është majtë në burg është rrah edhe nuk ka tregu kurgjë, e kanë pytë për ne çka po bëjmë, tek po bëjmë nuk ka folë ka thënë i keni dokumentat. E kanë marrë Xhavit Hazirin edhe ai nuk dihet ku është, është zhduk fare, edhe ai ka qenë nënpunës i këshillit por ai nuk është marrë për punë të këshillit është marrë për punë të veta, përpara ka qenë aktivist i këtyre organizatave politike brenda dhe jashtë Jugosllavisë. Kur u liru prej burgut ka ardh te na sikur kanë ardh plot, ka qenë te na në këshill po mendoj edhe Jakup Krasniqi që nifet sot, ka qenë anëtar i këshillit kanë qenë edhe plot të tjerë që mos ti përmendi por që janë likfidu (eliminua) prej anëtarëve të këshillit, jon likfidu ata bashkëpunëtorët ton në teren, bashkëpunëtorët që na kanë dhënë informata nga tereni, shembull nga Ferizaji e kanë marrë e kanë burgose e kanë rrah edhe e kanë qitë nga kati i dyte a i tret i policisë, e kanë qitë në tokë edhe kanë thonë qe ka kcy, ka dashtë me bo vetëvrasje, a nuk ka qenë vetëvrasje por e kanë shty. Kanë qenë kta Topalli, tash e pashë që është kandidu për kryetar të Ferizajit që jon burgos, ai ka shpëtu gjallë ky Topalli. Nuk po më bjen ndër mend, jon vra edhe të tjerë tash jon vra ma fort si aktivist të terrenit e jo si anëtar të këshillit, se anëtarët e këshillit kanë pas njëfarë mbrojtje ndërkombëtare, prandaj edhe ndoshta nuk kanë mujt në atë kohë, e kanë vra këtë Bajram Kelmendin por Bajram Kelmendin e kanë vra pasi që kanë fillu

bombardimet pra ka qenë në kohën e luftës, kështu që na kemi shpëtu. Në këtë rrugën time janë djeg trembëdhjetë shtëpia , në këtë mahallën time, shtëpia jonë ka shpëtu ,ka shpëtu se kemi ndejt na mrena se do ta zhdukshin, këtu karshi meje është djeg një shtëpi e një njeri krejt të thjesht ka qenë mjek stomatolog, ia kanë djeg shtëpin sepse aty ka banu një aktivist ndërkombëtar, ka banu me qera, pra kështu që na e kalum kohën e luftës në këtë mënyrë, edhe qështë e vërteta unë kom vazhdu punën, këtë aktivitet e kom vazhdu deri në fund të vitit 2005, nuk e kemi botu 8 numra të kësaj Boletinit, për arsye se në vitin 2004 kur ndodhën gjërat në Mitrovicë e dini atëherë qysh ka ndodh, u dogjën shtëpia por nisi me vrasjen e atyre tre fëmijëve, tre fëmijët që jon vra, jon vra se i ka njëkë policia, jon nxon fëmijët ndër veti shqiptarët me serbet në veriun e Mitrovicës edhe ata tu ike jon myt në ujë. Aty ka fillu ajo edhe mandej ndodhi krejt çka ndodhi, e në vitin 2004 kjo ndodhi në mars 2004, na dulëm me informatë, informata jonë ndryshonte nga informata e OSBE-së, e OSBE-ja at'here na ndihmonte neve, na ndihmonte edhe materialisht e tash kur doli, doli sikur na po i kundërvihemi OSBE-së, por na i kundërvihemi kujtdo që i shkel të drejtat e njeriut, kushdo qoftë, na nuk e kemi shpërnda këshillin edhe sot ekziston se edhe sot shkelen të drejtat e njeriut, na kemi qenë këshill për mbrojtjen e të drejtave të njeriut jo të shqiptarëve, serbëve, por të gjithkujt, kujt ti shkelen mirëpo u ndërpre ndihma ajo ndihmë që na jepshin, se neve diku prej 97-shit e mbrapa na kanë ndihmu organizatat ndërkombëtare, se krejt këto që po flasim na kanë kërku shpenzime, na krejt kemi qenë njerëz të përjashtuam nga puna, njerëz me një pension që kemi pas. Kështu që tash këshilli është tu jetu me ndonjë projekt, por nuk kanë të ardhura të rregullta, kurse unë kur kanë fillu me na dhënë ndihmë këta, na kemi pas nga një rrogë mujore, e vogël e vogël po ka qenë sa për mu majtë, ajo u ndërpre, kjo që u ndërpre u bë një gabim i madh po me duket se ky gabimi është pikërisht nga ndërkombëtares se në qoftë se na e shkruajmë raportin si e donë ai që ka fuqinë atëherë na nuk jemi këshill, nuk kemi kënd me mbrojtë e mbron ai vetvetën, por na jemi për me mbrojtë atë që shkelet, e kush e shkel, e shkelen kryesisht ata që e kanë fuqinë ata që kanë forcën.

Anita Prapashtica: Na tregoni cilat ishin ëndrrat e juaja si fëmijë.

Po si çdo i ri, por rinia e gjeneratës sime ka lindë në kohën e varfërisë edhe në kohën e okupimit të huaj, gjithnjë kemi andërruar që dikur të jemi të lirë edhe kur të luajmë me pola, të jemi te sigurtë qe nuk po na prek dikush. Edhe andrra e lirisë ka ardhë duke u pjekë edhe në familje, se familja e ka ni peshën e robërisë, e ka ni varfërinë e krijuar përkundër shëndetit ekzistues, për shembull babën e kom pas të shnosh e krejt këto. Mirëpo, ka ardhë koha e falimentimit, ka ardh koha e ikjes, kështu që baba pas një kohe t'u qenë unë fëmijë ka emigru ekonomikisht. Sikur kemi sot plot shqiptarë emigrantë nëpër krejt botën. Andrra ka qenë me shku me vizitu babën në Shqipni por me pa edhe Shqipninë. Kur e kom pa Shqipërinë aq shumë e kom dashtë, sa tan kohën kom andrru për të. E nuk ka qenë aq lule, edhe ajo ka qenë e varfër, ka qenë në kushtet e një okupacioni tjetër, shqiptari prej shqiptarit ka qenë i ndjekur në atë kohë, por ka ekzistuar shteti shqiptar. Qaj shtet shqiptar ka qenë tërheqës për ne edhe

kemi andrru m'u bashku me te. Nji prej andrrave tona ka qenë bashkimi me Shqipërinë, heqja e kufinit.

Unë kom shku në Shqipni për herë të parë në jetën time, kur kom qenë nxënës i klasës së tretë në gjimnaz ose i klasës së shtatë. Edhe na kemi pas njëfarë uniforme, kom shku me uniformë, ajo ka qenë uniformë normale, por ka qenë një kapele që i ngjante pak kapelës së shapkës së ushtarëve jugosllavë veç jo e asaj ngjyre. Kur kom ardhë si kom hi në kufi ma kanë hekë atë, ma kanë vu plisin e bardhë edhe për çudi s'e kom atë fotografi ndoshta e kom pas diku. Për çudi më duket se më ka nejtë shumë mirë se kom qenë i ri (qeshë) edhe ai rri bukur edhe kur jeni me tesha civile. Unë teshat civile i kom pas, nuk kom pas tirqë⁴, kështu që pra ajo është përshtypja e parë e takimit të me Shqipërinë, kjo ka qenë përmbi Zhur në Vërmicë të sodit, ku ka qenë kufini.

Më kujtohet atë kufi e kemi kalu edhe në vitin 1971, tash me gruan time edhe me vajzën time, vajza ime studente. Vajza ime ka dalë prej veturës, se me veturë kemi shku, kom pas njëfar lidhje me ambasadën shqiptare ma kanë dhënë vizën. Unë shkojsha, tash po flas për rastin e dytë '71-shit, tash po shkoj si anëtar i delegacionit tash zyrtarisht po shkojsha, por ma dhanë vizën edhe për gruan edhe për çikën që e kisha studente. Ajo doli prej veturës u ulë në dy gjunjë (qan) edhe e puthi tokën shqiptare, pra nuk është vetëm gjenerata ime por ishte edhe gjenerata juaj, vajza ishte atëherë njëzet vjeçare studente e Universitetit të Beogradit e Mjekësisë, por i'u dukë diçka tjetër. Shiqoni e kemi pa Shqipërinë në këtë rastin tjetër, kur keq për te nuk kemi folë, nuk ka qenë lule. I kemi parë femrat me gjithfarë teshash gjithfarë rrobash, punëtore por punojshin në fushë, punojshin në fabrikë, hyjshin në punë, për ndryshim nga ne që duhej me ikë me gjetë punë dika se s'kish vend këtu (Qeshë).

Unë nuk i kom pas andrrat që mund t'i ketë rinia sot, për shembull me pas një vajzë të bukur me të cilën do të dali do të shëtisë e do t'a shijoj jetën, ato nuk e kom pas në atë kohë, se s'kom pas kohë me menu për atë punë. Pikë së pari kom qenë në internet ku kemi qenë të gjithë djem, s'ka pas vajza fare. Në mbramje kur baheshin ato, na e kemi pas një bandë muzikore të formume prej nxanësve prej klasës së parë e deri në klasën e tetë, kishte edhe njerëz më të vjetër aty. Edhe banda muzikore kishte tango, fokstrot e krejt këto edhe kërcefshim djali me djalin, vajza s'kishim. Me dalë përjashta, ton ishim myslimanë njëherë mas pari, por shqiptarë, boshnjakë, maqedonë, por edhe nuk na qasnin.

Ndonjë prej të rriturve kishte chans me pas edhe vajzë, se kemi pas djem shumë të bukur. Për shembull ka qenë një Hajdar Xhema i zhvillim, i bukur, tona vajzat rreth konviktit tonë e këqyrshin atë, mirëpo ato të gjitha ishin ndihmëse në familje, nuk ishte vajza e pronarit, por ishin ato që punojshin. Mirëpo edhe ato nuk ishin çfarëdo si femra, pikë së pari shumica e atyre femra që punojshin si ndihmëse të shtëpisë ishin të shkollume. Ekzistonte shkolla që quhej "Shkolla e vajzave që bëhen ndihmëse të shtëpisë" pra kishte raste për me andrru edhe femra në atë moshën time, por unë nuk e mrina atë se unë në klasën e shtatë erdha në Prishtinë, (qeshë) kisha një ambient tjetër.

⁴ Veshje tradicionale e burrave nga Malësia e Madhe.

Mirëpo malli për atdhe ishte gjithmonë i pranishëm.

Unë kom fol edhe para kësaj here, e kisha një shok të mirë, ka qenë shumë shok i mirë, ai u bashku me rininë anti-fashiste e po me kërkon mu me hy qatëherë në rininë ku ishte, nuk du me hy me ty aty, se aty jonë serbë. E baba jem në atë kohë një rrobaqepës i thjeshtë, recitonte Lulet e Verës së Naim Frashrit, unë nuk djisha se kush ishte Naim Frashëri. Pra edhe pse jom shkollu serbisht, kom pas kontakt me shqipen nëpërmjet prindërve, besa edhe nëpërmjet hoxhës. Qysh nëpërmjet hoxhës? Më qun te hoxha me msu kto ritet fetare, me msu Elhamdulillahun për shembull, mirëpo atë hoxha e shpjegonte shqip për ndryshim nga mësuesja që krejt mësimin e zhvillonte serbisht. Pra shqipen kom fillu me msu prej babës prej nanës edhe prej hoxhës. Mësuesen e kom pas henez⁵ në '41-shin kur një pjesë e Kosovës edhe vendi jem Gjakova u bashkun edhe na erdhën mësues nga Shqipëria. Tash malli për Shqipërinë edhe u shtu se ndëgjojshe mësim edhe për Fishtën, edhe për Fan Nolin, edhe për Naim Frashrin e krejt u zgjanu horizonti i dijes edhe i mallit, se malli veç fillon e plotësohet me elemente të reja.

Këta djemtë që na erdhën nga Shqipëria, kta t'u qenë në Shqipëri t'u pasë Kosovën nën Serbi janë educu për me u kthy në Kosovë, për me u kthy me punu me jetu pranë familjes. Mirëpo janë educu edhe me këto idetë komuniste që po i thonë tashti, por nuk kanë qenë vetëm komuniste por kanë qenë çlirimtare edhe i'a kanë nisë luftës për liri edhe për pavarësi por edhe për drejtësi sociale. Për drejtësi sociale pse? Se Shqipëria ka qenë vend feudal, por feudal i vogël, nuk ka pas shumë prona të mëdha se Shqipëria vetë e vogël mjaft, por kanë qenë marëdhëniet feudale pra, fshatarët kanë qenë të shtypën prej agallarëve, bejlerëve ata që kanë qenë pasanikë. Këta punëtorët sikur në gjithë botën kështu që jonë bo komunista shqiptarët, kta fillun me i përhapë idetë komuniste te na. Na nuk i'u kemi bashku menjëherë këtyre ideve, na që jemi shkollu në kohën e Jugosllavisë së vjetër, për arsye se ne nuk e qujshim atë primare. Për na ishte primare me u çliru prej serbit edhe me u bashku me Shqipërinë, pra këto ishin pjesë të andrrave të mija që natyrisht edhe unë kom qenë i ri. Ka kalu kjo faza dikur kom fillu me marrë pjesë në luftë, kom shku në gjimnaz, në gjimnazin shqiptar këtu, kemi pas edhe vajza të gjimnazit shqiptar (qeshë). Edhe merreni me mend unë këtë gruan time e kom marrë prej gjimnazit, por jetoj me të në martesë prej vitit 1946 në bashkëshortësi, pra janë 70 e disa vjetë. Plus janë dy vjet para që jemi njoftë kshtu, plus janë një vjet që jemi afru pak hala, se unë nuk kom dashtë me u martu në atë kohë. E kom pas andërr shkollimin edhe për fat kur ka marrë fund Lufta e Dytë Botërore, ky Fadil Hoxha që ka qenë komandat i përgjithshëm, unë atëherë kom qenë i lirum prej kampit fashist, jo kampit nazist. Por po ju them këtë që më ka tërheqë në pushtet, erdh puna me më qu në Shqipëri, u afrova me Shqipërinë tash dojsa me nejt në Shqipëri tërë kohën, erdh koha me ardhë në fakultet edhe ndodhi kjo çka ndodhi, pra kohë për andërrim nuk kom pas shumë.

E mandej kur kom ra në andrra i kom realizu shumë shpejt se u martova ende pa i kry studimet, e

⁵ Gjuhë bisedore: tek me, akoma.

mora qit gruan, çikë atëherë, kjo ka qenë 16 vjeçe, 17 u martu, 18 vjeçe u bo nanë. (Qeshë) Pra ëndrrat rinore nuk i kom pas bash sikur i keni ju por megjithatë kanë lënë mbresat e veta.

Anita Prapashtica: Çka konsideroni si andrrën tuaj më të madhe?

Vehap Shita: Unë e konsideroj se familja osht' bërthama e shoqërisë. Unë në familje e kom arritë kulmin e asaj çka kërkohet, pra jom martu me kohë, kom bo djalin me kohë, kom bo çiken me kohë, djalin tjetër me kohë, një vajzë kom arritë t'a shkolloj në kohët mjaft të vështira, jo ekonomike, se kom punu ton kohën, e t'u punu ton kohën edhe krijon kushtet për një jetë normale. T'u studiu në Beograd, në atë kohë kur kjo ishte studente unë kisha telashe të mëdha ktu, telashe politike të cilat më sollën në konflikt me regjimin që ishte në fuqi. Ai konflikt t'u qenë çika jeme ende pa le.

Pra t'u qenë gruaja ime shtatzëne, e gruaja shtatzëne ka qene ende pa i bo tetëmbëdhjetë. E qysh atëherë unë erdha në një situatë shumë të vështirë mas së cilës edhe rashë në burg por megjithatë unë arrita t'a shkolloj çikën, ta bëjë doktor t'shkencës, ta bëjë profesor të fakultetit. Arrita djalin tjetër ta kryjë studimet të bohet elektro-inxhinier, tjetri të bohet arkitekt, të martohen të kenë fëmijë të krijojnë familje. Pra, jeta familjare për mu ka qenë komplet në rregull, nuk kom pas se çka të mendoj për to fare. Edhe nipat e mbesat i kom të mirë, një mbesë e kom prokuror të shtetit në Cleveland të Ohio-s. Një mbesë e kom avokat në New York, një mbesë tjetër e kom psikologe prapë në New York, një djalë e kom inxhinier në Texas, një nip e kom student në Texas, një mbesë e ka kry ktu në Prishtinë e ka kry ketë AUK-un, Universitetin Amerikan në Prishtinë pra krejt është në rregull kjo.

Për mu unë e kom mbri atë kulminacionin që mundet me mbri një familje. Jashtë familjes kom arritë të krijoj një emën, ç'është e vërteta marrja me politikë m'u më ka pengu në zhvillimin tem intelektual. Pse? Për arsye se ajo më ka marrë shumë kohë edhe ajo më ka ballafaqu me konflikte të nivelit shtetnor të atij shteti që ka qenë. Pra ju kom thonë edhe para kësaj here kom qenë në burg në kohën e Italisë, në kohën e Gjermanisë edhe në kohën e Partizanëve e sikur të isha vetëm nuanës e vetëm student krejt këto nuk kishin me ekzist, por gjatë tërë kësaj kohe unë kom arritë të punoj edhe në punën time kom bo nifar emri i cili osht' respektu.

Qe për shembull dje isha në Plavë, edhe fola disa fjalë atje, pash që njerëzit po më njohin, njerëzit pe dinë se kush jom unë. Pra nuk ka gja ma të mirë se me të kujtu dikush, me të nderu dikush edhe me të nderu për të mirë, mos me thonë ky njeri kaloi tri regjime, tri lufta edhe pra ja qëndron qysh qëndron. Në anën tjetër kom mbri me bo libra në gjuhën shqipe të mijat origjinale, por kom arritë që t'mos të kufizohem vetëm në paraqitjen time në fushën e letërsisë. Për shembull e kom botu librin për Hasan Mekulin, i cili nuk ka pas guxim me bo libër për veti, ai ka qenë kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve e s'ka pas libër të vetin. I kom pas thonë në një rast "More Hasan unë nja tre libra i kisha bo prej punimeve tuaja e ti nuk pe bon një", "Po s'po muj". Masi ka vdekë Hasani unë e kom bo librin "Romani Shqiptar prej Hasan Mekulit" i kom nxjerr krejt ato çka ka shkrujtë për roman ai ka qenë kritik sikur unë. Ka

qenë kritik i letërsisë, unë kom qenë kritik i letërsisë por edhe i teatrit, teatrit të filmit. E ai përqendruam në letërsi, por në letërsinë botnore, ai e ka përcjell letërsinë botnore se ka pas landë studimi. Unë e kom pas gjuhën dhe letërsi shqipe, ai e ka pas letërsi botnore edhe osht' orientu nga letërsia sllave kështu që e ka përcjellë shumë letërsinë ruse. Letërsia ruse osht' shumë e pasun, osht' aq e pasun sa që osht' e pa përfshihem, me dashtë ju me studiu, ju duhet shumë punë. Edhe unë kom lexu nga letërsia ruse, Tolstojin. E kom përkthye ni "Ledina e Lavrume" të cilën e kom studiu, ende më kujtohet ajo është interesant, Ledinen e Lavrume e kom përkthi me dorë, të shkruame me dorë, nuk kom ditë me përdorë as maqinën e shkrimit, se mo kompjuteri nuk ka qenë fare.

Anita Prapashtica: Çka në përgjithësi në jetë e konsideroni si arritjen më të madhe tuajën?

Vehap Shita: Kjo puna e veprimtarit për të drejtat e njeriut ose veprimtarit në fushën e veprimtarisë kombëtare, më ka penguar në punën time profesionale. Se une kur ja kom nisë të shkruaj, qysh kur kom qenë nxënës jom marrë me një lloj kritike, qysh referatet që kemi bo në orë të mësimi, në orë të gjuhës, i kom bo zakonisht si lloj vështrimesh. Tash po në këtë punë e kom mbërri njëfarë rezultati, qasi rezultati qe po t'i përkushtohesha vetëm asaj do të kisha mbërri diçka ma tepër se sa që kom mbërri. Kështu që energjinë time mendore dhe intelektuale e kom nda në disa pjesë, prandaj nuk muj me thonë se çka kom mbërri ma së shumti. Ndoshta puna ma e madhe që kom bo është kjo që kom mbërri me i vu bazat e përcjelljes së punës skenike artistike, pra të teatrit kryesisht, mandej edhe filmit edhe të letërsisë. Të letërsisë do të mbërritsha më shumë por në letërsi kom bo gjithsej dy libra, që kanë 400 faqe por kom mujtë me bo edhe ma shumë. Pse kom mujtë me bo edhe ma shumë? Kom mujtë me bo ma shumë për arsye se unë jom marrë me studimin e letërsisë, pra kisha me bo studim mbi letërsinë të asaj natyre që do të thoshin diçka, që do të më bojshin edhe mu ndër si shkrimtarë por edhe do të ishte njëfarë pasurimi i letërsisë sonë. Unë në fushën e letërsisë e kom bo "Gjurmëve të letërsisë" ndoshta e kisha bo tash 1, 2 ajo Gjurmëve të Letërsisë o' botu dy herë, osht' shitë, osht' zhdukë tash nuk muj me gjetë. I kom dy, tre numra ktu vetë.

Po në teatër i kom bo gjithashtu dy filma libra, por në fushën e letërsisë kom bo shumë përkthime në gjuhën shqipe nga letërsia botnore. Ç'është e vërteta krejt nëpërmjet serbishtes edhe nga letërsia jugosllave e popuj të ndryshëm të Jugosllavisë po kom bo romane. Kom bo tregime, kom bo ese edhe zakonisht kom bo një lloj zgjedhje të gjanave të veprave që munden me interesu opinionin shqiptar, sidomos në qoftë se kanë lidhje me ne si popull si komb. Për shembull kur i kom përkthye esetë e Kërlezhës, i kom gjetë esetë ku ai ka shkru. E dini kush osht' Kerlezha? Mirosav Kërlezha një shkrimtar bashkëkohor natyrisht ka vdekë ai tashti, ka vdekë 80 e disa vjet, ka vdek para disa vjetëve. Ato ku ka shkru ai mirë për shqiptarët, për shembull ai shkruan për vrasjen e 200 shqiptareve në vitin 1944, t'u qenë ushtarë të mbretnisë Jugosllave edhe shkrun "Qysh mundet qeveria jugosllave, shteti jugosllav me i vra ushtarët e vetë?". Ata kanë qenë shqiptarë por kanë qenë ushtarë jugosllavë, ata osht' dashtë

me i vra në kazermë, pra ka shkru për shumë gjana.

Në anën tjetër osht shkrimtare me famë botërore, osht' përkthly në disa gjuhë, prej tij kom përkthly "Novelat" kom përkthly edhe "Ciklin e Glebajve" që osht një familje që shkatërrohet në kushtet e mikroborgjezisë, kur mikroborgjezia don me u bë borgjezi e nuk ka fond për atë, nuk ka mbështetje trashëgimore mendoj edhe nuk ka mbështetje ekonomike, nuk ka mbështetje intelektuale. Pra, e ka paraqitë në mënyrë shumë interesante jetën në tranzicion që osht' interesante edhe për ne. Në anën tjetër osht' një vepër kulmore, pra veprat kulmore i kom përzgjedhë nga letërsia kroate por atëherë jugosllave i thojshin.

Nga letërsia serbe e kom përkthly romanin "Miq" të Sereniqit, ku një shqiptar që shkon si hamall⁶ në Beograd edhe i pastron shpijat e zotërive atje, e shtin thëngjillin, i qan drutë edhe vjen e bohët inxhinier në Beograd. Ai don me paraqitë fuqinë biologjike, intelektuale të shqiptarit, i cili ka ardhë si punëtor i thjeshtë e ka përfundu si inxhinier, inxhinier ndërtimtar jo inxhinier çfarëdo. Po ju përmendi këto për arsye se ai pandal⁷ i këtij, në këtë roman, e ka një serb të shtresës mikroborgjeze ku ky shqiptari ka ardhë si punëtor i thjeshtë me i'a shti thëngjillin. Aq shumë mbërrin, ai serbi osht' një njeri leshkan, që rri i shtrirë, lexon gazetën atëherë s'ka pas televizion edhe është bllof i njeriut edhe e krahason me shqiptarin i cili pa kushte aq shumë mbërrin, mu më ka interesu shumë ajo, fati i tij edhe quhet "Miq" se kta bëhen miq. Aq bëhen miq sa vjen në situatë sa ky serbi tu e pa kte qysh po zhvillohet dashurohet në të, në pikëpamje homoseksuale. Nuk vjen deri te diçka ma e randë por tregohet, ai tregon se qysh ai dashurohet në jetën, nuk dashurohet vetëm në fizikun e tij, por e sheh këtë një djalë i ri i cili ka mbërri krejt këto edhe me këtë e tregon fuqinë e njeriut që ka ekzist. Shiqoni kjo e ka origjinën pak ma të thellë, se vetëm shqiptarët që janë trashëgimtarë të ilirëve kanë ekzist pa u shkri, se këtu kanë ekzist edhe popuj të tjerë. Kanë ardhë edhe gjermanë, kanë ardhë edhe italianë, kanë ardh edhe gotët, kanë ardhë edhe sllavët. Sllavët kanë ekzist si pushtues, na kemi ekzist si autokton, e kjo shihet prej romanit "Miq" pra të ardhunit janë bo miq me vendasit edhe kanë ekzist njani prej tjetrit. Njoni ka mri prej punëtorit të thjeshtë me u bo inxhinier, tjetri ka pas shkollë e i ka pas krejt por ka mbetë i shtrim në shtrat.

Kështu kjo është një pjesë e veprimtarisë sime, por nga letërsia botërore kom përkthly "Historinë e Filozofisë Kineze", "Historinë e Filozofisë Indiane", kom përkthly "Platonin" e Antikës, kom përkthly "Xhordano Brunon", kom përkthly "Brekthin" nga teatri dialektik gjerman, kom përkthly "Ledinën Ruse", e kom përkthly Turkenjevin, kom përkthly Dostojevskin. Shiqoni pra një radius shumë i gjanë i veprimtarisë dhe aty në atë fushën e përkthimeve pa marrë parasysh që është interpretim i veprës së huaj, por osht' art sepse ju duhet të thelloheni në atë për me mujtë me interpretu e me qenë art edhe në gjuhën tande. Pra kjo është një pjesë që unë e quaj si njëfarë kulminacioni i veprimtarisë sime në

⁶ Turq.: portier (i derës).

⁷ Strukturë e përkohëshme nga pëlhura, zakonisht përsoret në ceremoni fetare, martesë.

këtë fushë. Në fushën letrare kom mbërri t'i paraqes shkrimtarët tanë në gjuhën serbe, në gjuhën kroate, në gjuhën boshnjake, në gjuhën sllave e nëpërmjet këtyre gjuhëve edhe në gjuhë të tjera. I kom përcjellë disa vlera ma të mëdha të kulturës, të letërsisë sonë, t'u fillu prej Ismajl Kadaresë e deri te Anton Pashku, Ali Podrimja, Azem Shkreli e të tjerë. Por me këto për shembull e kom botu prej Ali Podrimjes një përmbledhje të vjershave që quhet "Në Zot e hetuan gjarprin" e kom botu serbisht ajo shqip nuk osht' botu, osht' botu diku tjetër. Po "Në Zot e hetuan gjarprin" ka një kuptim shumë të thellë, Zot është sundimtari, te na ka qenë sundimtar Titoja. Edhe në Zot e hetuan gjarprin, se na doli neve gjarpër, se krejt këto pjesët e Jugosllavisë u bënë të pavaruna neve na e murrën pavarësinë, e kush e ka fajin? E ka fajin Zoti, po në këtë fjali Zoti nuk është fjala për perëndinë por Zoti për njeriun që është në krye, pra një shkrimtar i cili, fatkeqësisht Ali Podrimja vdiq unë kom shkru për Ali Podrimën, kom botu në leksikonin e shkrimtarëve jugosllav.

Me titull "Pesnik pobuna i otpora" me përkthi shqip do të thotë poet i rebelimit dhe i qëndresës. Shiqoni kjo është botu me redaktor anëtarin e akademisë së shkencave në Serbi. Ju e dini akademia e shkencave osht' çerdhe nacional e shovinizmit serb, edhe atë e kanë botu, po unë e kom bo qashtu që ata t'a botojnë se nuk i'u kom thonë që osht' i rebelizmit shqiptar, as i kryengritjes shqiptare. Po, i kom thonë i rebelizmit si fenomen botnor që ekziston edhe sot, i kemi rebelet, por rebelet pozitivë jo rebelet shkatërrues. Po rebelet që don me shpëtu prej një okupacioni, prej një shtrëngese. Pra me përpjekjet e mija, qato modeste sa kanë qenë kom arritë t'ia prezantoj opinionit jugosllav 15 vepra në gjuhën serbo-kroate, e nëpërmjet saj edhe në gjuhë të tjera. Edhe ktu nuk jom vetëm, ajo është me rëndësi. Pse? Me këtë punë qe jom marrë unë është marrë edhe Esad Mekuli, tash po merren edhe disa të rinj është Ismail Smaka që po përkthen prapë në serbisht.

Unë nuk do ta quaja veten të suksesshëm sikur të mos vinte dikush mas meje, sikur të mbaronte me mu atëherë nuk osht' në rregull. Kështu është edhe në fushën e teatrit, po e përmendi teatrin se unë kom shkru herët për teatrin, ende po kërkohet prej meje me shkru nuk po muj se s'po kom kohë, po merrem me punë të tjera, kjo është e mira se po mirem edhe andej edhe andej e po mbetën pa u kry krejt. Në anën tjetër po ka tash të rinj që po merren, janë disa emra të rinj, spo i përmendi se dikujt i mbetë hatri, veç jon disa djem të rinj. Megjithëqë kur shkruaj unë thonë "Ah, ky ka shkru". Tash kta të rinjët duhet mi favorizu ma tepër se te këta mbetet puna. Në jetën time kom arritë që prej vitin '90 e deri në vitin 2005 kom arritë ta pasqyroj çdo gja, çdo shkelje që i osht' bo popullit tonë. Kushdo që e ka bo, qoftë e ka bo gjermani, qoftë e ka bo italian, qoftë e ka bo serbi, kroati apo edhe shqiptari, ajo domethënë shumë, se bota mendoj unë do të qeveriset atëherë kur të likuidohen kufijtë ku mbeten të drejtat e njeriut. Po ajo është utopi të cilën unë nuk mbërrij me mbërri, e që besoj nuk e mbërrin as ju. (Qeshë) Se interesat po ekzistojnë...

Anita Prapashtica: A e konsideroni si arritje qasjen politike ose veprimtarinë politike?

Vehap Shita: Unë ju kom fol për politikë para kësaj here, por mund të ju them për kohën e sotit, është një shkrimtar i yni që ndoshta e dini, Faik Konica ka thënë, “Oh Zot ruje Shqipërinë prej shqiptarëve, se prej armikut e mbrojmë vetë”.

Kosova kështu si osht’ po ju thomë vajzë e mirë [i drejtohet të pranishmes] nuk osht’ Kosova që e kemi andrru. Po osht’ Kosova që osht’ shliru, osht’ e vërtetë se Kosova ma në fund ka dalë edhe osht’ shpallë e pavarur me pëlqimin e Fuqive të Mëdha që sot i prijnë botës jo vetëm neve. Pra, osht’ kjo fitore shumë e madhe që osht’ arritë. Por Kosova si shtet ende nuk është ai që e kom andërru unë, e atë që e kanë andrru shumë përpara nesh. Pse? Unë që e përcjelli pak edhe historinë, e jom t’u e përkthye një histori të madhe, po shof se po përsëritet situata kur ka thonë Faik Konica, “Oh Zot shpëtoma Shqipërinë nga shqiptarët, se nga armiku e shpëtoj vetë”. Na nga armiku kemi shpëtu tash duhet t’a shpëtojmë nga njoni tjetri, për fat të keq aq shumë po zihen shqiptarët ndër veti, aq shumë jon të hutum saqë nuk po dinë çka po kërkojnë.

Na i kemi në Kosovë disa parti politike të cilat të gjitha thonë se jemi të djathta, të gjitha thonë se jemi të majta, të gjithë thonë se jemi të qendrës. Tash nuk e di sa po i zen e djathta sa po i zen qendra edhe sa po i zen e majta, se të gjithë janë edhe e djathtë edhe e majtë edhe qendër; por, secila osht’ për me mujtë me pas udhëheqjen me pas pushtetin, me pas besa edhe dobitë ekonomike, dobitë materiale. E na që kemi luftu nifar kohe shumë moti por edhe tash nuk kemi luftu për kështu, bile në qoftë se kemi pas kesi rastesh na edhe atëherë ka pas edhe ka ndryshime në pikëpamje ekonomike midis njerëzve. Unë po i’u kallxoj një anekdotë, ka ardhë një instalater i ujit me e rregullu te unë këtë qepin, rubinetin edhe kur p’i lypi sa kom me pagu, ta zomë thotë “Pesë euro”. “Qysh?” thomë “pesë euro, ai m’i ka marrë njëzet”, ky thotë “puna vlen për njëzet, por ju jeni arsimtar e këto 15, po i lë kontribut për arsimin se e keni rrogën e vogël”. Merreni me mend ajo pjesa që e edukon fëmijën tem ai merr në disproporcion me atë që marrë unë, unë marrë shumë ma tepër për të njëjtën punë, e ai merr shumë ma pak. Edhe na prej asaj nuk kemi shpëtu ende, nuk di kur do të shpëtojmë, pra me marrë kështu këto divergjenca sjellin në një situatë kur njeriu duhet të luftojë për një kafshatë bukë. Kur duhet të ndodhë ktyne që ju ka ndodhë ktyne grupit të emigrantëve tonë që janë mbyllur në Hungari, këto kanë me na ndodhë deri kur të bohemi me mend.

E unë po i’u thomë, se di a i’u kom thonë para kësaj here, një grup i ekspertëve japonez që kanë ardhë para njëzet vjetëve në Kosovë, e i kanë studiu resurset ekonomike, natyrore që ka Kosova, kanë thonë se Kosova ka vend për pesë milion njerëz. E Kosova sot i ka dy milion e s’i ka as dy e gjysmë, e ai ka thonë se ka vend, ka mundësi me i ushqy, me i rritë në bazë të resurseve, e pse? Kemi tokën pjellore, kemi ujin, Kosova nuk vunë për ujë, na po vuajmë për ujë por nuk e kemi të rregullum çështjen e ujit. Stinët, stinët i ka edhe pranverën edhe verën krejt resurset për ekzistencë i ka, Kosova ka një nëntokë shumë të pasur. Pra, jemi 12-13 vjet që jemi të lirë ende nuk kemi një fabrikë ku mund t’i shtijmë në

punë dy mijë- tre mijë vetë, se jemi orientu me ndërtu shtëpia, me ndërtu godina. Plot godina janë shpazë sot, se kanë fitu njerëzit me qira atëherë kur kishim shumë të huaj e pak vend, e tash ka shumë vend se jonë ndërtu shumë e të huajt kanë shku edhe kanë mbetë ato bosh.

Në anën tjetër e kemi situatën që s’kemi ndërtu kurgjo, po ju them kështu për arsye se situata nuk është hiq ma mirë edhe në Shqipëri, për të cilën na kemi andërru edhe Shqipëria sot është nën mbikëqyrjen. Deri kur na do të kemi dikun? Na kur kemi ardhë partizanë, s’i kemi ardhë kemi hy, na kemi qenë pak partizanë shqiptarë që kanë marrë pjesë, menjëherë komandën e kanë marrë serbët. Unë nuk kom mujt mo me vendosë qysh unë po du vetë, është dashtë me prit çka po bëhet edhe sot e kemi qat situatë. Sot edhe në Shqipni kanë mbikëqyrës të huaj, nuk e kemi vetëm EULEX-in e UNMIK-un edhe ata e kanë OSBE-n e ku di unë, pse? Për arsye se nuk po dimë me u marrë vesh. Me shiqu kështu situatën na në Kosovë nuk kemi mbërri me hekë kapuçin e Serbisë. Ju kom thonë noshta para kësaj here, që na praktikisht ende jemi në Serbi, qysh? Jemi në Serbi se 1244-shi na ka lon nër Serbi, ende nuk e kemi thy konferencën e Londrës e 1913-shit, na sot jemi me situatën që na ka lënë me 1913 konferenca e Londrës.

Duhet me pru punën, me bo Kosovën qashtu që me vendosë qashtu qysh do vetë edhe me mujtë me u bashku më Shqipërinë në qoftë se don. Mundet me ekzist, se ekzistojnë shtete që kanë dy tri kombe, për shembull gjermanët e kanë Austrinë e kanë edhe Gjermaninë, e kanë Zvicrën. Një pjesë e Zvicrës osht’ gjermane, një pjesë osht’ franceze, një pjesë osht’ italiane, mund të ekzistojnë. I kemi dy Kore, i kemi dy Maqedoni, një Maqedoni osht’ te ktu ku ka qenë, një Maqedoni është në Greqi, Greqia s’pe pranon Maqedoninë pse osht’ Maqedonia e saj veriore në Greqi. Pra, mundet me ekzist, por mundet me ekzist në bazë të drejtave të njeriut. Në qoftë se ju i gëzoni të drejtat e njeriut në shtetin tuj si person por edhe si komb, si komunitet komunal, si komunitet i rrethit, si komunitet i qarkut, si komunitet i krahinës, si komunitet i shtetit edhe si subjekt ndërkombëtar, s’ka rëndësi se qysh me kon osht’, por shumicën e bojnë ata që e kanë shumicën. Për shembull gjuhë zyrtare në Francë osht’ frëngjishtja ka arabë, algerianë, ka gjermanë. Në Gjermani, gjermanishtja osht’ gjuhë zyrtare por ka edhe francezë ka edhe polakë, pra edhe te na munet me qenë por gjuha zyrtare duhet me qenë gjuha e vendit. Pra, kur ta mbërrimë këtë, unë po flas qysh do të ishte mirë, por për me qenë kështu, duhet baza me qenë mirë. Baza osht’ qikjo që kemi kriju me 12 qershor të vitit 1999. Na prej 12 qershorit ne 1999 jemi të lirë për me kriju Kosovën qashtu qysh osht’ mas miri, a që s’po mundemi fajin e kemi vetë me ju thonë të drejtën. Por për fat të keq, këtë faj nuk e ndajmë vetëm na, këtë faj e kanë edhe në Shqipni se edhe në Shqipni s’e kanë punën fort ma mirë. Kështu që, ruaje Zot Shqipninë prej shqiptarëve se prej armikut e ruaj vetë, se kur vjen puna me kap pushkën edhe na dimë me kap pushkën. (Qeshë)

Një prej librave të parë që e kom botuar në gjuhën shqipe quhet “Skena Shqipe” ktu jonë kritiket e teatrit popullore krahinor që i thoshim atëherë libri është botu në vitin 1964 por përmban vetëm shfaqjet e autorëve shqiptar, libri i dytë që është bo është me tematikë teatrit është “Kur ndizen

dritat” ku jon pjesët teatrale të dramës shqipe e teatrit popullor krahinor të Kosovës ose të Teatrit Kombëtar që po i thonë tash, përmban vështrime kritike të teatrit por edhe të shkrimtarëve të tjerë jo vetëm të shkrimtarëve shqiptar por edhe shkrimtarëve botërorë, qofshin jugosllav, qofshin tjerë. Ky libër është përkthyer edhe në gjuhën serbe, ky është botu në vitin 1977 pra bajagi shumë ni kohë ma të gjatë. E unë e numëroj si libër me rëndësi librin “Shkëndijat e para” të cilin e kemi përgatit bashkë me Zekero Rexhon edhe Mehmet Gjivorin, që përmban shkrimet e shkrimtarëve të Kosovës të botuar deri në vitin 1956. Mandej kom botu librin tem “Gjuha dhe letërsisë” i cili është ribotuar me të njëjtën përmbajtje me të njëjtin titull por është ribotuar pak më vonë edhe këto jon veprat origjinale. Kom përgatit edhe librin tjetër, librin e tret të “Gjuhës dhe letërsisë” por nuk e kom botu se me ka nixon koha e luftës, me të vërtet para luftës vitet 90, kur kom fillu të merrem me punë tjera e jo vetëm me punë të letërsisë, se ndërkohë unë kom vazhdu të përkthej sikur kom përkthe bajagi shumë por në kohën e viteve 80-90 kom përgatit edhe librin “Kristomacin” që e kom kthy në gjuhën e sodit edhe e kom botu të plot, po e përmendi të plot për arsye se po ky libër është botu në Shqipëri por me pjesë të hequra, për shkak të regjimit që ishte atëherë në Shqipëri i kane hekë disa gjana që ju kanë dukë shumë fetare, por fetar kanë qenë edhe shqiptarët nuk kanë qenë vetëm të krishterët. Edhe në kohën e vitit 80 e kom rikendu edhe e kom transkriptu “Psalmet e Davidit” nga Djata e Vjetër të përkthyer nga Kristoforidhi, e kom dhanë në një rën anë origjinalin e Kristoforidhit në anën tjetër e kom transkriptimin e përkthimit të Kristoforidhit, edhe në fund e kom dhanë rikëndimin e “Psalmet e Davidit” për arsye se Psalmet e Davidit jon shkru në origjinal, jon poezi, e Kristoforidhi i ka bo si prozë, Psalmet numërohen proza e parë origjinale letrare, artistike në gjuhën shqipe. Kjo është pjesa e punimeve origjinale, unë ju fola edhe para kësaj here se jom marrë shumë me përkthime edhe kom shumë vepra të përkthyer nga gjuha serbe, por nga letërsia jugosllave dhe letërsia botërore. Tash po ju numëroj disa tituj, këtu e kom nda veprat nga letërsia dhe kultura botërore, përshembull e keni “Historinë e filozofisë kineze” botuar në gjuhën shqipe por përkthyer nga unë, botuar nga Rilindja, e keni tjetrin “Historinë e filozofisë indiane”, e keni librin shumë interesant të Emanul Kontit “Mbi të bukuren e të madhërishmën”, e keni Gjordan Bruno “Optimizmi i mendimit të lirë”, e keni “Filozofinë e marksizmit” nga Gajo Petroviqit, Gajo Petroviqi është kroat edhe pse e ka emrin serbisht. Nga letërsia e shqiptarëve që kanë shkruar kroatisht e kom “Uria në ledinë” roman nga Augustin Stipcevic. Letërsia Jugosllave e kom ni tërësi të veprave, nga Mirosov Kerlezha kom përkthe edhe novelat.

Nga letërsia jugosllave e kom edhe ni roman të Sllovan Sereniqit që është shumë interesant për arsye se për subjekt e ka një punëtor shqiptar, i cili shkon si punëtor i thjesht që prenë dru e që i shtinë thëngjillin në bodrum edhe përfundon si inxhinier i ndërtimeve edhe si mik i një familjes në të cilën ka punu si shërbëtor. Mu me ka interesu shumë ky roman për arsye se është shkru shumë bukur nga Sllovan Sereniqi i cili është ni shkrimtar serb i mirë, i mirë i shkrimtar kështu se si njeri nuk më intereson shumë, por këtu ka tregu fuqinë mendore, intelektuale të shqiptarit i cili prej një punëtori të thjesht vjen e bohet edhe zë vend, formon familje, formon karakter. E kom një roman të Mirko Kovaqit ky është një serb i cili është rrit edhe ka punu në Kroaci, mik shumë i madh i shqiptarëve i cili në kohën

e fërkimeve të mëdha midis shqiptarëve edhe serbëve na ka majtë anën neve. E kom edhe “Kronikën e Traunikut” të Iva Andriqit ju kom thënë edhe para kësaj here unë e kom përkthye “Kroniken e Traunikut” sepse është literaturë e bukur edhe për këtë Iva Andriqi ka fitu çmimin nobel për letërsi, e është shkru shumë bukur në atë kohën e vet, për fat të keqë është tregu se Iva Andriqi si funksionar i ministrisë së jashtme të Jugosllavisë së atëhershme ka bo njëfarë programi, një farë projekti për copëtimin e Shqipërisë midis Serbisë ose Jugosllavisë së atëhershme dhe Greqisë e Italisë, e aty ka ra në provim si njeri, por si letrar ka mbërri me fitu edhe çmimin nobel për letërsi. Unë ju fola para kësaj here mjaft për veprën e Mirosav Kerlezhes, nga Mirosav Kerlezha kom esetë shumë të bukura ku shkruan për qëndrimin brutal terrorist, terrorit shtetëror ndaj shqiptarëve, për pushkatimin e 300 shqiptarëve ushtar të qeverisë jugosllave ku Jugosllavia i vret ushtarët e vet edhe pse ata ishin, ata ishin nënshjetas jugosllav por me origjinë shqiptare pra ata jon vra tamon vetëm se shqiptari është politikë raciste që ka njëkë pushteti serb për me mujt me realizu të drejtën e vet ndaj Kosovës edhe përzënie e shqiptarëve nga Kosova, e ajo është një dokument shumë i mirë që vërteton atë që ka thënë Dimitër nja dhjetë vjet më parë, me veprën e njoftun “Serbia e Albania” ku përshkruan golgotën e shqiptarëve nëpërmjet golgotës serbe. Por unë kom zhvillu një aktivitet të madhë edhe për përkthimin e shqiptarëve në gjuhën serbe, siç kom thënë në biografinë time përveç 40 librave të përkthyer në gjuhën shqipe kom përkthye rreth 15 libra në gjuhën serbe, ndër ato kom zgjedh ato që kom menu që është ma e mira edhe sidomos ajo që munet me e prezentu letërsin bashkohore shqiptare të shkruar në Kosovë po edhe të shkruar në Shqipëri. Nga Shqipëria unë kom përkthye “Kështjellën” e Ismail Kadaresë, “Kronik në gurë” të Ismail Kadaresë edhe “Dimrin e madhë” të Ismail Kadaresë. Nga letërsia shqipe bashkë me Rexhep Qosen e kemi përgatit librin “Gjurmime” antologji e prozës në Kosovë, ku i kemi paraqit shkrimtarët shqiptar të Kosovës me një parathanje shumë të mirë të vetë Rexhep Qoses e me përkthim nga unë, përkthim në gjuhën serbe, serbo-kroate, në variantin e Bosnjës se siç e dini serbishtja i ka disa variante. Këtu jon tregimet e Hivzi Sylejmanit, të Ramiz Kelmendit, Anton Pashkut, Azem Shkrelit, Rexhai Surroit, Mensur Raifit, Teki Dervishit, Jusuf Gurxhovit. Këto janë disa prej tregimeve që na si autor të kësaj antologjie i kemi zgjedh, nga Anton Pashku kom botuar edhe tregimet që unë i kom quajtur ndër ma të mirat për atë kohë, tregimet fantastike “Nën qarr po rrinte Vasha”, “Ura”, “Floçka” etjera etjera, është interesant se nga Anton Pashku e kom përkthye edhe romanin “Oh” i cili nuk ka mbërri mu botu edhe në gjuhën serbe, por unë e kom përkthye edhe e kom lon të përkthjem.

Në vitet 80, kah fundi I viteve 80, në vitet 90 jam marrë mjaft me punime monografike duke dashur me tregu identitetin e disa figurave të lëvizjes Nacional Çlirimtare por edhe të lëvizjes Nacionaliste, por krejt ne marsh te saj të luftës për çlirimin nga Sërbia gjegjësisht nga Jugosllavia e atëhershme. Në kuadrin e kësaj kam botuar librin monografik Zekero Rexha, patriot, humanist, intelektual e motiv. Kom botuar librin Emin Duraku “Qëndresa për çlirim e bashkim kombëtar vizion lufte e flijimi, shënime memorialë”. Kom përgatit për botim librin “Fadil Hoxha një jetë në shërbim të atdheut”.

Kom botuar librin bashkë me Halit Shabanin që Shabani i Becit figurë e ndritur e nacionalizmit

shqiptar, ky është një luftëtar i vjetër i para luftës së dytë botërore i cili ka qenë Kaçak mali, ka luftu kundër Perandorisë Osmane i cili ka qenë si kaçak, ka luftu kundër Serbisë së parë, kundër Serbisë së dytë edhe i ka ra hise me luftu edhe kundër Serbisë së tretë pra edhe në prag të përfundimit të luftës së dytë botërore. Kom botuar për Qel Shabanin të cilin e kom punu bashkë me nipin e tij, unë nuk e kom ditë kush është Qel Shabani, deri kur kom ik nga kampi nazist edhe kom fjet një natë në shtëpinë tij edhe ky duke qenë nacionalist, anëtar i Lidhjes së dytë të Prizrenit, luftëtar në forntin nga Mali i Zi për mbrojtjen e kufijve etnik të Shqipërisë së atëhershme, Shqipërisë të vitit 41-44. për shoqatën e veteraneve të luftës e kom bo librin “Krah i luftës, vetëvendosje e shtetësi Kosovës”, pse?, se në vitet 1990-2012 ish luftëtarët e LRQ-se janë frontu, kanë marrë anën e lëvizjes për çlirimin e Kosovës, qofte anën e lëvizjes paqësore të cilës i ka pri Lidhja Demokratike në krye me Ibrahim Rugovën, qofte ushtrisë çlirimtare të Kosovës të cilës i ka pri Adem Jashari, ktu jon protestat që nacional çlirimtarët, anti fashist të Kosovës, i kanë bo me të kësaj Këshillit të Sigurimeve të Kombeve të Bashkume, Unionit Evropian edhe krejt opinionit evropian edhe SHBA-ve e kanë përkrah lëvizjen për çlirimin e Kosovës tu u mbështet në dokumentet e veta që i kanë nxjerr në kohën e luftës, njoni prej atyne dokumenteve është e ashtu quajtura Rezolut e Bujanit në të cilën pjesëmarrësit e asaj konference që kanë qenë prej të gjitha kombësive të asaj kohe, në pranin e misionit ushtarak anglez e kanë nxjerr rezulcionin me të cilën shqiptarëve të Kosovës u njihet e drejta e vetëvendosjes deri në shkëputje pra ndarje nga Jugosllavia ndarje nga Serbia edhe për bashkim me Shqipërinë. Unë jom mundu me këtë libër me dhonë identitetin e kësaj lëvizjeje, jo me i rehabilitu se ata skan pas nevojë me i rehabilitu, ata e kanë rehabilitu veten me luftën e tyre me gjakun e tyre deri në nëntor të 44-shit, në nëntor të 44-shit kur kanë hy partizanët në Kosovë, e mbrapa drejtimin e kanë marrë serbet edhe ata të cilët i kanë ndegju serbet prandaj kemi ardh në situatën në të cilën kemi ardh edhe kanë ndodh ato çka kanë ndodh. Ky libër është libër dokument, nuk është libër koment, por ka vetëm të periudhës 1999-2012.

Gjatë kësaj periudhe për të cilën folëm kom pas kënaqësinë të bashkëpunoj me shokë, kolegë të cilët kanë bo veprat e veta qoftë për akademinë e shkencave, qofte për Rilindjen, qofte për Fakultetin Filozofik, për institucione politike të tjera. Unë po ju përmendi përshembull librin e Mark Krasniqit “Kujtime e Përjetime” unë kom bo këtu punën time si lektore edhe redaktor, i kom nimu sa kom ditë e sa kom mujt edhe për të cilën ai më është mirënjohës që i kom punu një libër që është mjaft i madhë i ka rreth 600-700 faqe. I kom nimu edhe Pajazit Nushit për librin “Psikologjia e Përgjithshme” por jo vetëm për këtë, i kom ndihmu edhe për librin “Kujtesa” edhe për punimet e tij që jon edhe për mendimet e Frojdit se ai është psikolog e krejt lidhur me bibliotekën psikologjike që e ka përgatit ai në gjuhën shqipe un jomë mundu me i nimu.

Ky është një libër me poezi të zgjedhura nga Divani i Shapsita Brezit të cilin e ka përkthi baba Qazim Bakalli i Gjakovës ky është baba i Bektashive, babanë e kom pas Bektashi edhe për hatër të babës e kom marrë këtë libër në dorë por përkthyes është Qazim Bakalli i cili e ka përkthye në dialektin e Gjakovës, unë e kom kthy e kom bo në gjuhën letrare shqipe, përndryshe është një libër shumë i bukur me poezi orientale të përkthyer nga persishtja, ky Qazim Bakalli ka qenë mësues po u be dikur baba,

por ka qenë zotues i persishtës, i arabishtës edhe i turqishtës. Pra një kulturë e gjanë prej një njeriu të thjesht, i një mësuesi të thjeshtë i cili e ka lon msusin masi e ka pa nevojën që duhet mu bo Bektashi, edhe ka vdek Bektashi,, por ka kërku që këtë libër ta botoi vetëm masi të vdes ai, unë i kom dërzua shoqatës së Bektashive në Tiranë edhe ata e kanë botu me rastin e 800 vjetorit të lindjes së këtij autori, ky është një autor persian, i njoftun në letërsinë botërore, e këtë përvjetorin e kanë kremtu UNESCO-ja. Me kaçë kisha me i dhanë fund, faleminderit shumë që keni ardh.

Anita Prapashtica: Faleminderit edhe juve që keni gjetë kohë.

Vehap Shita: Me kënaqësi.